



FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION



Matrica e monitorimit mbi krijimin e mjedisit të favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile

Raporti për Kosovën 2019

Autore & hulumtuese: Mirjeta Ademi

Udhëheqës i hulumtimit: Dren Puka



Ky material/realizim është financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar. Përgjegjësia për përmbajtje i takon tërësisht autorit. Sida jo domosdoshmërisht i pasqyron pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë raport.

Balkan Civil Society Development Network

Adresa : Macedonia Street 43-1/9, 1000 Skopje, Republic of North Macedonia

Telefoni: +389 2 6144 211

E-maili: executiveoffice@balkancsd.net

Ueb faqja: www.balkancsd.net

www.monitoringmatrix.net

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile

Adresa: Musa Tolaj, Lam A, Hyrja 1, Kati i12-të, nr. 65-1 Qendra Nartel, Prishtinë 10000

Telefoni: +383 (0)38 600 633, +383 (0)38 600 644

E-maili: office@kcsfoundation.org

Ueb faqja: www.kcsfoundation.org

Versioni elektronik është vënë në dispozicion në: <https://www.kcsfoundation.org>, në ueb faqen e BCSDN-së: <http://www.balkancsd.net/> dhe në: <http://www.monitoringmatrix.net>

Ky raport është pjesë e aktiviteteve të projektit "Mbrojtja e hapësirës publike – Qendra regjionale për zhvillimin e shoqërisë civile", që financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) dhe implementohet nga Balkan Civil Society Development Network (BCSDN), në bashkëpunim me anëtarët e organizatave anëtare nga Ballkani Perëndimor.

Përmbajtja e këtij raporti dhe informacioni, si dhe pikëpamjet e prezantuara nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar dhe opinionin e SIDA. Përgjegjësia për informatat dhe pikëpamjet e pasqyruara në këtë dokument bie tërësisht mbi autorin (autorët).

Përmbajtja

Përmbajtja	5
Lista e figurave	6
Hyrje	8
Falenderime dhe mirënjohje	9
Historiku- Pasqyra përmbledhëse e vendit	10
Përmbledhje e përgjithshme	13
Pasqyra përmbledhëse e shoqërisë civile	13
Gjetjet kryesore	15
Rekomandimet kryesore	16
Gjetjet	17
Fusha 1: Garancitë themelore ligjore të lirive	17
Nën-fusha 1.1. Liria e Asocimit	17
Nën-fusha 1.2. Liritë tjera	23
Fusha 2: Korniza për zbatueshmëri dhe qëndrueshmëri financiare të OShC-ve	27
Nën-fusha 2.1. Trajtimi tatimor/fiskal për OShC-të dhe donatorët e tyre	27
Nën-fusha 2.2. Mbështetja institucionale	29
Nën-fusha 2.3. Burimet njerëzore	35
Fusha 3: Marrëdhënia Qeveri-OShC	38
Nën-fusha 3.1. Korniza dhe praktikat e bashkëpunimit	38
Nën-fusha 3.2. Përfshirja në procesin e politikbërjes dhe vendimmarrjes	41
Nën-fusha 3.3. Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve sociale	46
Konkluzionet dhe rekomandimet	50
Shtojcat	52
1. Metodologjia e matricës së monitorimit	52
2. Shënime mbi metodologjinë dhe sfidat në vend	53
3. Burimet e shfrytëzuara/Bibliografia	54
4. Lista e të intervistuarve	56

Lista e figurave

Figura 1 Kërkesat e raportimit (përfshirë atë financiare) që kërkohen nga autoritetet shtetërore	21
Figura 2 Përvojat e OShC-ve që janë të përfshira në aktivitetin ekonomik ..	21
Figura 3 Procedura e përfitimeve tatimore	28
Figura 4 OShC-të që kanë pranuar fonde publike.....	30
Figura 5 Përfshirja e OShC-ve në zbatimin e strategjisë.....	39
Figura 6 Ftesa e OShC-ve për konsultim publik	41
Figura 7 Përqindja e pranimet të komenteve të dërguara nga OShC-të	42
Figura 8 Qasja e OShC-ve në informatat publike	44

Lista e shkurtesave

BCSDN	Balkan Civil Society Development Network
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
MM	Matrica e monitorimit
PPP/LFT	Parandalimi i pastrimit të parave dhe Luftimi i financimit të terrorizmit
PSK	Përgjegjësia Sociale e Korporatave
DOJQ	Departamenti për Organizata Jo-Qeveritare
KCSF	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
ZKM/ZQM	Zyra e Kryeministrit të Kosovës/Zyra për Qeverisje të Mirë
OPP	Organizatë për Përfitime Publike
SPP	Statusi i Përfitimit Publik
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto

Hyrje

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe Balkan Civil Society Development Network janë të ngazëlyer që të prezantojnë edicionin e pestë të *Matricës së monitorimit mbi krijimin e mjedisit të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile*, në të cilën përmbledhen zhvillimet e vitit 2019 në Kosovë.

Ky raport është pjesë e një sërë raportesh vendore që përfshijnë shtatë vendet e Evropës Juglindore: Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Serbinë dhe Turqinë. Është vënë në dispozicion edhe raporti rajonal, i cili përmbledh gjetjet dhe rekomandimet për të gjitha vendet dhe një platformë të uebit që ofron qasje në të dhënat e monitorimit për secilin shtet në www.monitoringmatrix.net.

Matrica e monitorimit, e zhvilluar në vitin 2013 nga BCSDN me mbështetjen e anëtarëve të saj ICNL dhe ECNL, paraqet parimet dhe standardet kryesore që janë identifikuar si vendimtare për të ekzistuar, në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet si mbështetës dhe favorizues për funksionimin e OShC-ve. Matrica është e sistemuar në tri fusha, secila e ndarë në nën-fusha¹:

1. Garancitë themelore ligjore të lirive;
2. Korniza për zbatueshmëri dhe qëndrueshmëri financiare të OShC-ve;
3. Marrëdhënia Qeveri-OShC

Parimet, standardet dhe treguesit mbështeten në liritë dhe të drejtat e garantuara ndërkombëtarisht dhe në praktikën më të mira rregullative në nivel të Bashkimit Evropian dhe të shteteve të Evropës. Matrica synon të përcaktojë kushtet e favorshme që i përshtaten shoqërisë civile për të funksionuar dhe për t'u zhvilluar në mënyrë efektive. Njëkohësisht, ajo synon të përcaktojë një kornizë reale e cila mund të aplikohet dhe zbatohet nga autoritetet publike. Duke pasur parasysh që sfidat kryesore qëndrojnë në zbatim, treguesit specifikohen për të monitoruar kornizën ekzistuese ligjore dhe aplikimin e saj në praktikë².

Përveç monitorimit të vazhdueshëm detajor dhe cilësor, në vitin 2015 u prezantua një vlerësim i krijimit të mjedisit të favorshëm, me një kategorizim mjedisor të radhitur prej "mjedisi i cenuar në mënyrë absolute" deri tek "mjedisi i favorshëm në tërësi". Sistemi u krijua për të trajtuar nevojën për komunikim vizual "të përmbledhur" dhe efektiv të gjetjeve dhe kapacitetin e prezantimeve sistematike të ndryshimeve në krijimin e mjedisit të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile përgjatë shteteve dhe viteve. Ky sistem nuk e zëvendëson por e plotëson vlerësimin cilësor, pasi që raportet përshkruese të vendeve janë baza mbi të cilën kryhet kategorizimi.

Hulumtimi i kryer në kuadër të MM-së synon të ofrojë një raportim zyrtar (shadow reporting) në lidhje me krijimin e mjedisit të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile dhe të ndikojë në politikën e zgjerimit të BE-së dhe mbështetjen e financimit për zhvillimin e qëndrueshëm dhe strategjik të sektorit.

1. Si mjet hulumtues për vlerësimin e gjendjes së mjedisit ligjor, rregullativ dhe financiar në të cilin funksionin OShC-të me status për përfitim publik, Matrica synon të reagojë ndaj nevojave të OShC-ve për të pasur në dispozicion produkte hulumtuese që mbështeten në dëshmi dhe kapacitete për të avokuar për ndryshime të politikave në aspektin e krijimit të një mjedisi më të favorshëm për shoqërinë civile.

2. Për këto qëllime, në kuadër të pjesës së gjetjeve, raporti i referohet Udhëzimeve mbi Mbështetjen e BE-së për Shoqërinë Civile në vendet e zgjerimit 2014-2020 dhe formon lidhje reciproke me të.

Falenderime dhe mirënjohje

Gjatë mbledhjes dhe analizimit të të dhënave për këtë raport, KCSF u bazua në punën e ekipore, që përfshiu pjesën kryesore të stafit të saj dhe u mbështet në rezultatet e projekteve dhe iniciativave të kryera nga ana e saj. Prandaj, kontributi i secilit anëtar të ekipit të KCSF -së është shumë i çmuar.

Përveç kësaj, KCSF dëshiron t'ua shprehë mirënjohjen e saj të gjitha OShC-ve, përfaqësuesve të institucioneve publike dhe të donatorëve, si dhe përfaqësuesve të sektorëve tjerë, të cilët kanë dhënë opinionet dhe mendimet e tyre përmes anketave dhe intervistave, si dhe përmes ofrimit të mundësisë për qasje në informacione/dokumente publike. Informacioni i grumbulluar nga aktorët relevantë në lidhje me punën e shoqërisë civile në Kosovë ishte vendimtar për të përmbledhur tërë fushëveprimin e kësaj matrice. Në fund, KCSF falenderon mbështetjen e ofruar nga Zyra Ekzekutive e BCSDN-së, e cila ishte shumë e dobishme për të futur gjithë informacionin përbrenda një formati të përcaktuar qartë, që është i krahasueshëm në nivel rajonal dhe ofron hapësirë të mjaftueshme për informacionin specifik të vendit.

Historiku

Pasqyra përmbledhëse e vendit

Viti 2018 u karakterizua me paqëndrueshmëri politike në Kosovë. Qeveria e udhëhequr nga Kryeministri Ramush Haradinaj kishte mungesë të shumicës parlamentare, që nënkupton se për shkak të mungesës së kuorumit shumë mbledhje të Kuvendit kishin përfunduar para se të mund të fillonin. Si rezultat, ndërmjet muajit prill dhe qershor, rreth 60 pika të rendit të ditës nuk u morën në konsideratë dhe u shtynë për mbledhjet e mëvonshme të Kuvendit. Gjatë vitit, agjenda e Qeverisë u përqendrua tërësisht në dy çështje: dialogu me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve dhe demarkacioni i kufirit me Malin e Zi. Sferave që lidhen drejtpërdrejt me mirëqenien e qytetarëve si sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik, lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar iu kushtua pak vëmendje. Për më tepër, diskursi publik u dominua nga një ide e parashtruar nga presidenti i atëhershëm i Kosovës Hashim Thaçi, rreth korrigjimit të kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ky propozim ka nxitur tensione të mëdha tek partitë politike në opozitë dhe publiku i gjerë në Kosovë.

PBB e Kosovës në vitin 2018 ishte 6.7³ miliardë €, e dyta më e ulëta në vendet e Ballkanit Perëndimor. PBB-ja e Kosovës për kokë banori është 3.64 euro, që është dhjetë herë më e ulët se mesatarja e BE-së. Paga mesatare mujore është 360 €⁴, teksa rritja ekonomike varet nga remitancat e diasporës, me rreth 80% të investimeve të huaja direkte që vijnë nga kosovarët të cilët jetojnë jashtë vendit. Shkalla e papunësisë është rreth 30%, ndërsa papunësia e të rinjve është mbi 50%. Kosova posedon moshën mesatare më të ulët në Evropë, mirëpo çdo vit ekonomia e saj gjeneron vetëm gjysmën e numrit të vendeve të punës që nevojitet për të rinjtë të cilët inkadrohen në fuqinë punëtore⁵.


Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit midis Kosovës dhe BE-së është në fuqi që nga viti 2016, përderisa në nëntor të të njëjtit vit BE-ja lansoi 'Agjendën për Reforma Evropiane'. Megjithatë, qeveritë pasuese kanë qenë të ngadalta për të zbatuar aktivitetet që do të përshpejtonin procesin e integritit evropian. Nga ana tjetër, ratifikimi i marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi në vitin 2018 hoqi bllokadën përfundimtare të aplikuar ndaj Kosovës për lëvizjen pa viza në zonën Shengen. Në këtë aspekt, Komisioni Evropian konfirmoi se Kosova kishte përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara për liberalizimin e vizave, që ishin përcaktuar nga Këshilli Evropian. Pavarësisht faktit se shoqëria civile gjatë vitit 2018 operoi në rrethana të pafavorshme politike, të cilat kryesisht ndikuan në proceset e avokimit për shkak të mungesës së kuorumit në Kuvend, prapëseprapë u shënuan disa zhvillime pozitive. Njësia për Inteligjencë Financiare filloi vlerësimin e rrezikut sektorial në lidhje me financimin e terrorizmit, pas këmbënguljes për një kohë të gjatë të shoqërisë civile. Qeveria publikoi raportin vjetor rreth proceseve të saja të konsultimit publik.

³ Banka Botërore, 2018.

⁴ Banka Botërore, 2018.

⁵ MacDowall, 2020.

Përkundër pengesave që e karakterizojnë tërë procesin e konsultimit publik, raporti paraqet një hap pozitiv në aspektin e përmirësimit të mëtejshëm të procesit të pjesëmarrës në politikbërje.



Përmbledhje e përgjithshme

Pasqyra përmbledhëse e shoqërisë civile

	2018	2019
Numri i organizatave të regjistruara (sipas llojit)	Të regjistruara: 541 Shoqata: 508 Fondacione: 32	Të regjistruara: 569 Shoqata: 513 Fondacione: 32
Ligjet kryesore të shoqërisë civile	Ligji për : <ul style="list-style-type: none"> Mbrojtjen e sinjalizuesve Ndërmarrjet shoqërore Legjislacioni sekondar: <ul style="list-style-type: none"> Standardet minimale për procesin e konsultimit publik në komuna 	Ligji për : <ul style="list-style-type: none"> Lirinë e asociimit në OJQ-të Qasjen në dokumentet publike Strategjia qeveritare për: <ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunim me shoqërinë civile 2019 – 2023
Ndryshimet relevante në kornizën ligjore	Projektligjet për: <ul style="list-style-type: none"> Lirinë e asociimit në OJQ-të Punën Pushimin e lehonisë Qasjen në dokumentet publike Koncept dokumentet për: <ul style="list-style-type: none"> Tubimet publike Vullnetarizëm 	Projektligjet për: <ul style="list-style-type: none"> Punën Pushimin e lehonisë Koncept dokumentet për : <ul style="list-style-type: none"> Tubimet publike Vullnetarizëm Shërbimet sociale dhe familjare
Financimi shtetëror (për vitin paraprak) (organet kryesore dhe shumata)	Fondet publike të ndara për OShC-të Raporti qeveritar krahasuar me analizën e KCSF-së: Gjithsej (në milionë): €24 me €9 Qeveria (në milionë): €13 me €7 Komunat (në milionë): €8 me €2	Fondet publike të ndara për OShC-të Raporti qeveritar krahasuar me analizën e KCSF-së Gjithsej (në milionë): €21 me €7 Qeveria (në milionë): €14 me €6 Komunat (në milionë): €7 me €1

<p>Burimet njerëzore (punonjësit dhe vullnetarët)</p>	<p>3,729 punonjës kanë paguar vazhdimisht kontributet e tyre gjatë 12 muajve të fundit: 6,762 punonjës posedojnë më shumë se një profesion, njëri prej tyre është në sektorin e SHC-së: Vullnetarë: 5,104</p>	<p>4,009 punonjës kanë paguar vazhdimisht kontributet e tyre gjatë 12 muajve të fundit : 9,533 punonjës posedojnë më shumë se një profesion, njëri prej tyre është në sektorin e SHC-së : Vullnetarë : 10,000</p>
<p>Bashkëpunimi ndërmjet OShC-së dhe Qeverisë (organet e reja dhe relevante: mekanizmat konsultativ)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Platforma në internet për konsultim publik • Zyra për Qeverisje të Mirë • Departamenti për Media dhe Komunikim Masiv në Kuvendin e Kosovës • Këshilli Kombëtar për Integrim Evropian 	<ul style="list-style-type: none"> • Platforma në internet për konsultim publik • Departamenti për Media dhe Komunikim Masiv në Kuvendin e Kosovës • Këshilli për zbatimin e Strategjisë qeveritare për zhvillimin e shoqërisë civile • Zyra për Qeverisje të Mirë • Këshilli Kombëtar për Integrim Evropian
<p>Sfidat tjera kryesore (p.sh. mungesa e të dhënave zyrtare në lidhje me SHC-të)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e të dhënave zyrtare rreth sektorit të shoqërisë civile, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me vlerën ekonomike të sektorit 	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e të dhënave zyrtare rreth sektorit të shoqërisë civile, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me vlerën ekonomike të sektorit

Gjetjet kryesore

Ka pasur disa zhvillime pozitive në lidhje me kornizën ligjore mbi krijimin e mjedisit të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë. Ligji për Lirinë e Asocimit, Rregulloret për financimin publik të OJQ-ve dhe procesin e konsultimit publik, si dhe Strategjia për bashkëpunim me shoqërinë civile kanë shënuar hapat fillestarë të zhvendosjes së vëmendjes të autoriteteve publike në aspektin e përmirësimit të legjislacionit për zhvillimin e shoqërisë civile. Megjithatë, ka hapësirë për t'u përmirësuar, ku veçanërisht duhet të bëhen më shumë përpjekje dhe të vihen më shumë burime në dispozicion për të ngritur kapacitetet e zyrtarëve publik dhe për të krijuar mekanizmat e zbatimit, si dhe për të zbatuar dhe monitoruar kornizën dhe strategjitë ekzistuese ligjore.

Gjetjet kryesore të raportit

1.	<p>Ndryshimi i Ligjit nr. 06/L-043 për Lirinë e Asocimit në OJQ-të ka përcaktuar institutet si formë të tretë ligjore për të regjistruar një organizatë. Për më tepër, ky ligj ka rritur mbrojtjen kundër ndërhyrjes së shtetit në çështjet e brendshme të OShC-ve dhe ka reduktuar periudhën e regjistrimit të organizatave prej 60 në 30 ditë. Gjithashtu, është zgjeruar lista e aktiviteteve për përfitime publike në: mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, mbështetjen e praktikave demokratike dhe të shoqërisë civile, mbrojtjen e konsumatorit, si dhe ndihmën dhe mbështetjen ndaj refugjatëve, teksa të gjitha OJQ-të janë të obliguara t'i kryejnë transaksionet e tyre financiare përmes bankës.</p>
2.	<p>Legjislacioni mbi Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit nuk është në përputhje me Rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) dhe Direktivën e BE-së 2015/849. Ky legjislacion i konsideron OShC-të si subjekte raportuese duke aplikuar ndaj tyre kërkesa të rrepta. OShC-të kanë raportuar për vështirësitë me të cilat përballen gjatë qasjes në shërbimet bankare, siç janë: prania e detyrueshme fizike e themeluesve të organizatës në raste kur hapet, përditësohet apo mbyllet llogaria bankare dhe tarifat e papërcaktuara të mirëmbajtjes së llogarisë që aplikohen nga bankat komerciale.</p>
3.	<p>Gjatë vitit, u shënuan dy iniciativa që kishin për qëllim kufizimin e lirisë së shprehjes. Këshilli Prokurorial i Kosovës miratoi një rregullore në të cilën nënvizohet se zyrtarët e këtij këshilli mund të komunikojnë me mediat dhe gazetarët vetëm atëherë kur Kryeprokurori njoftohet paraprakisht. Në rastin e dytë, Komisioni i Pavarur për Media inicioi hartimin e politikës që ndalon raportimin e vendimeve të gjykatës për zyrtarët publikë deri në vendimin përfundimtar.</p>
4.	<p>Rregullorja nr. 04/2017 që rregullon kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OShC-të nuk është zbatuar tërësisht edhe pas tre viteve të hyrjes në fuqi. Ka një rritje të thirrjeve publike për propozime, gjithashtu, raporti për fondet publike që u shpërndahet OShC-ve është duke u publikuar çdo vit. Megjithatë, ky i fundit, përkundër faktit që kontribuon në krijimin e një kulture të transparencës, krahas përfituesve të OShC-ve, klasifikon gabimisht edhe subjektet tjera ligjore. Kurse kërkesat tjera, siç janë monitorimi dhe vlerësimi i fondeve publike më në fund kanë filluar të zbatohen.</p>
5.	<p>Strategjia e re qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019 - 2023 ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2019. Objektivat e kësaj strategjie përfshijnë: ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve civil dhe zhvillimin e mekanizmave implementues për zbatimin e Rregullores për standardet minimale për konsultim publik dhe Rregullores për financim publik për OShC-të, avancimin e sistemit të ofrimit të shërbimeve publike nga OShC-të dhe rritjen e vullnetarizmit në programet me interes publik.</p>
6.	<p>Hyrja në fuqi e Rregullores nr. 05/2016 për Standardet minimale për procesin e konsultimit publik ka përcaktuar një sërë standardesh dhe procedurash sistematike për procesin e konsultimit publik. Sidoqoftë, praktika tregon se jo të gjitha elementet, të cilat e plotësojnë dhe e bëjnë të efektshëm procesin e konsultimit publik dhe të cilat përcaktohen nga Rregullorja, janë duke u marrë në konsideratë. Megjithëse karakterizohet me mungesë të standardeve dhe kriterëve sistematike për të zhvilluar konsultim publik, miratimi i fundit i Udhëzimit Administrativ për konsultimin publik në komuna shënon një hap të rëndësishëm.</p>

Rekomandimet kryesore

Përderisa një mori fushash kanë nevojë për përmirësim në aspektin e legjislacionit, pjesës tjetër i nevojitet zbatimi i duhur i rregulloreve tashmë të miratuara. Përmirësimet domethënëse në kornizën rregullative në kuadër të fushave të Ligjit për OJQ-të, konsultimit publik dhe financimit publik mund të jenë të qëndrueshme vetëm nëse garantohen kapacitetet dhe burimet e mjaftueshme nga ana e qeverisë. Përpjekjet e vazhdueshme për të hartuar legjislacionin mbështetës për zhvillimin e shoqërisë civile dhe për të siguruar zbatimin e duhur, në realitet mbeten një sfidë e madhe për sektorin e shoqërisë civile dhe atë publik. Kjo ndodh, në veçanti, për shkak të numrit të kufizuar të institucioneve dhe OShC-ve që veprojnë në këtë fushë.

Rekomandimet kryesore të raportit

1.	Departamenti për OJQ-të duhet të hartojë aktet nënligjore të Ligjit për OJQ-të me përfshirjen e OJQ-ve. Për më tepër, D-OJQ duhet të ngrisë kapacitetet e saj për të zbatuar plotësisht mandatin e tij. Personeli i D-OJQ duhet të trajnohet në lidhje me parimet ndërkombëtare të lirisë së asociimit dhe dispozitat e reja të përfshira në ligjin për OJQ-të, të miratuar rishtazi.
2.	Njësia për Inteligjencë Financiare, Ministria e Financave dhe Banka Qendrore duhet të hartojnë dhe miratojnë kornizën rregullative për bankat dhe OShC-të bazuar në rekomandimin 8 të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF), përkatësisht të kryejnë vlerësimin e rrezikut sektorial, për të mundësuar shërbime të pakufizuara financiare për OShC-të dhe për të inkurajuar transaksionet bankare në kuadër të operacioneve financiare të OShC-ve.
3.	Ministria e Financave dhe Administrata Tatimore duhet t'i trajtojë specifikat e OShC-ve në legjislacionin primar, si dhe format e raportimit. Këto duhet të harmonizohen me Ligjin për OJQ-të për të siguruar përfitime specifike për OShC-të. Duhet të ngriten kapacitetet e nëpunësve civilë, në mënyrë që procedurat administrative në lidhje me lirin nga tatimi për OShC-të dhe donatorët të zhvillohen në mënyrë më efektive.
4.	Ministria e Financave, së bashku me organizatat tjera buxhetore të nivelit qendror dhe lokal, duhet të punojë në rritjen e transparencës në lidhje me fondet publike që iu janë ndarë OJQ-ve, me fokus në monitorim dhe vlerësim. Duhet të përmirësohet sistemi i ruajtjes së të dhënave në aspektin e përfituesve dhe shumave që u ndahen OJQ-ve. Gjithashtu, duhet të ngriten më tepër kapacitetet e zyrtarëve publik për të zbatuar në tërësi kërkesat që derivojnë nga Rregullorja për fondet publike.
5.	Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZQM ZKM) duhet të ndajë një buxhet të caktuar dhe të ngrisë kapacitetet e saja njerëzore për zbatimin e duhur të Strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile. Përveç kësaj, metodologjia e vlerësimit të zbatimit të Strategjisë duhet të përditësohet, në mënyrë që të mundësohet një prezantim gjithëpërmblëdhës dhe i saktë i të dhënave.
6.	Institucionet e nivelit qendror duhet të sigurojnë që proceset e konsultimit publik të organizohen tërësisht në përputhje me standardet e specifikuara në Rregulloren për konsultimin publik. Duhet të rritet përqindja e hartimit të politikave dhe projektligjeve të pranishme në kriteret për një konsultim efektiv publik. Përveç platformës në internet për konsultim publik, duhet të shfrytëzohen edhe mjetet tjera të konsultimit, për të mundësuar më shumë qasje për OShC-të dhe mbarë qytetarët. Së fundi, duke u bazuar në qëndrimin pozitiv dhe gatishmërinë e një numri të nëpunësve civilë, në përgjithësi, duhet të fuqizohen kapacitetet e nëpunësve civilë për zbatimin e Rregullores, teksa OShC-të duhet të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e saj. Sa i përket nivelit lokal, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe komunat duhet të punojnë për të funksionalizuar në tërësi zbatimin e standardeve minimale për procesin e konsultimit publik në nivel lokal, ndërsa gjithashtu marrin përsipër zhvillimin e fushatës informative duke promovuar kështu mundësitë që janë në dispozicion për qytetarët dhe OShC-të.

Gjetjet

Fusha 1: Garancitë themelore ligjore të lirive

Nën-fusha 1.1. Liria e Asocimit

1.1.1. Themelimi i OShC-ve dhe pjesëmarrja në OShC

[Krijimi i mjedisit të favorshëm](#) është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Liria e asocimit garantohet me Nenin 44 të Kushtetutës së Kosovës. Ligji nr. 06/L-043 për lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare është ndryshuar rishtazi dhe ka hyrë në fuqi gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019. Procesi i hartimit të këtij ligji u karakterizua me orvatjet e shoqërisë civile për të siguruar harmonizimin e tij me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Ligji për OJQ-të garanton të drejtën për t'u asociuar në tri forma ligjore: shoqata, fondacione dhe institute. *Instituti* u prezantua rishtazi si një formë ligjore, si rrjedhojë, është lënë afati prej një viti për organizatat ekzistuese që dëshironin të ndryshonin formën e tyre ligjore.

Legjislacioni sekondar që përcakton regjistrimin dhe funksionimin e instituteve është në proces të hartimit. Asocimi në sindikata, parti politike, bashkësi fetare, etj., rregullohet përmes ligjeve të veçanta. Në vitin 2018, hyri në fuqi Ligji i ri nr.06/L-22 për Ndërmarrjet Sociale. Për të siguruar statusin e ndërmarrjes sociale, personat juridikë duhet të aplikojnë në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ligji përcakton që ndërmarrjet sociale të kenë të drejtë që deri në 30% të fitimit të tyre ta përdorin për pagat e personelit të tyre. Megjithatë, organizatat e shoqërisë civile theksuan se nuk ekzistojnë përfitime të vërteta nga ky ligj. Ligji përcakton fushat shumë të kufizuara të aktiviteteve, cakton procedurat kohë-harxhuese të regjistrimit dhe nuk ka ndonjë përkufizim të qartë se çfarë është një ndërmarrje sociale. Ligji as nuk përmban ndonjë dispozitë kufizuese që do t'i obligonte organizatat të veprojnë vetëm në disa zona të caktuara, e as nuk e kufizon numrin e organizatave që mund të veprojnë për qëllime të ngjashme.

Liria e asocimit ushtrohet në mënyrë të barabartë për individët dhe subjektet ligjore që synojnë të themelojnë shoqata, fondacione ose institute. Mbrojtja ndaj çfarëdo forme të diskriminimit garantohet me Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi. Askush nuk duhet të keqtrajtohet për një vendim në lidhje me dëshirën për të asociuar apo për të mos asociuar, dhe asnjë personi nuk duhet t'i kërkohet që të asociojë kundër vullnetit të tij. Aktivitetet e OShC-ve duhet të jenë në përputhje me parimet e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, të përcaktuara me Kushtetutë, Ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare që janë në fuqi. Regjistrimi i një organizate nuk është i detyrueshëm. Korniza ligjore

mundëson themelimin e organeve të organizatave me bazë në komunitet. Sidoqoftë, kjo kornizë ligjore nuk i përcakton ato si kategori e veçantë. Megjithatë, për ta siguruar statusin ligjor duhet të përmbushen disa kriteret e caktuara. Meqenëse shoqatat janë organizata me anëtarësim, themelimi i tyre kërkon të paktën tre persona fizikë ose juridikë. Fondacionet mund të themelohen nga një person ose me anë të testamentit, teksa kërkohen fonde fillestare; kurse institutet mund të themelohen nga të paktën një person. Ligji i ri ka shkurtuar procedurën e regjistrimit nga 60 në 30 ditë. Regjistrimi është falas, ndërsa zbatimi i rregullave të regjistrimit është i thjeshtë. Platforma në internet për regjistrimin e OShC-ve e lehtëson procesin. Rrjetet regjistrohen si shoqata, prandaj, vlejnë të njëjtat rregulla dhe procedura sikurse ato që përcaktohen me Ligjin për Lirinë e Asocimit në OShC-të. Nuk ekzistojnë pengesa që e vështirësojnë komunikimin në internet duke përfshirë komunikimin në internet me grupet jashtë vendit.

Që nga 31 dhjetor 2019, zyra e regjistrimit publik të OJQ-ve numëron 10,124 organizata⁶. Në vitin 2019, u regjistruan 569 OShC, që paraqet një trend të ngjashëm të disa viteve të njëpasnjëshme të regjistrimit të organizatave brenda një viti. OShC-të përmbledhin një spektër të gjerë të veprimeve, siç janë; personat me nevoja të veçanta, fuqizimi, demokratizimi dhe zhvillimi i shoqërisë civile. Shumica e OShC-ve të anketuara⁷, të regjistruara gjatë vitit të kaluar, nuk raportuan për ndonjë formë të detyrimit nga ana e autoriteteve shtetërore për t'u regjistruar. Asnjë prej OShC-ve të anketuara⁸ nuk pohuan se janë përballur me ndonjë formë të kufizimit gjatë ushtrimit të lirisë së asocimit, qoftë kjo në formë elektronike ose formë fizike. Gjatë viteve të fundit, ka pasur një rritje të iniciativave të paregjistruara ad-hoc. Këto iniciativa zakonisht i përqendrojnë aktivitetet e tyre në fuqizimin e grave dhe mbrojtjen e mjedisit, ndërsa një karakteristikë e përbashkët e tyre është se ato i ndërprejnë aktivitetet e tyre sapo të jetë zgjidhur një çështje e caktuar. Asnjë përfaqësues ose anëtar i grupeve joformale⁹ nuk ka raportuar për pranimin e ndonjë kërkesë nga autoritetet shtetërore për t'u regjistruar, e as për sanksionimin për shkak se nuk ka qenë i regjistruar. Asistenca juridike e ofruar nga Instituti Demokratik i Kosovës ndaj iniciativës qytetare, që ka kundërshtuar ndërtimin e hidrocentralit në qytetin e tyre, është një shembull i bashkëpunimit midis iniciativave të paregjistruara dhe OShC-ve.

Prej organizatave të anketuara, 18¹⁰ u regjistruan gjatë vitit të kaluar. Për 14 prej tyre, zbatimi i procedurave të regjistrimit perceptohet si i lehtë, ndërsa për 11 OShC-të e anketuara, procedura e regjistrimit nuk është e kushtueshme.¹¹ Rreth 50% të OShC-ve¹² potencuan se procedura e regjistrimit kishte zgjatur më shumë se 60 ditë (siç ishte përcaktuar me ligjin e mëparshëm për OShC-të). Shtatë prej 18 OShC-ve¹³ i konsideruan procedurat administrative si të tepërta. Shumica e OShC-ve kanë perceptuar se vendimmarrja nga Departamenti i OJQ-ve nuk ishte as arbitrare dhe as e ndikuar politikisht. Të dhënat tona të anketës tregojnë për nivele të ulëta të rrjetëzimit ndërmjet organizatave kosovare dhe organizatave homologe ndërkombëtare. Rreth 40% e OShC-ve refuzuan anëtarësimin në ndonjë rrjet, ndërsa 15% e OShC-ve të anketuara janë pjesë e vetëm një rrjeti.¹⁴ Rreth 10% e organizatave të anketuara¹⁵ janë të anëtarësuara në dy ose tri rrjete. Nuk ka pasur raste të raportuara në lidhje me kufizimin për pjesëmarrje në ndonjë rrjet.¹⁶

⁶ Regjistrimi publik i OShC-ve, Departamenti për Organizatat Jo-Qeveritare, qasje e realizuar në mars 2020

⁷ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁸ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹⁰ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹¹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹² Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹³ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹⁴ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹⁵ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹⁶ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

1.1.2. Ndërhyrja shtetërore

Krijimi i mjedisit të favorshëm është kategoria e caktuar që përshkruhet nga gjetjet e këtij standardi.

Ligji nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në OJQ, i shpallur së fundi, përfshinë masat e reja në lidhje me mbrojtjen nga ndërhyrja shtetërore. Në përgjithësi, institucioneve shtetërore u ndalohet të përfshihen në çfarëdo veprimtarie që kufizon lirinë e asociimit. Prej tyre pritet që të krijojnë një mjedis të favorshëm që stimulon OShC-të për përbushjen dhe avancimin e misionit dhe aktiviteteve të tyre.

Nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare për vitin 2019, por një vit më parë, 20 OShC¹⁷ u pezulluan nga Departamenti për OJQ-të në kuadër të Qeverisë. Baza ligjore është Udhëzimi Administrativ GRK – No: 02/2014, i cili rregullon regjistrimin dhe funksionimin e OJQ-ve. Ky Udhëzim Administrativ rregullon organizatat dhe parashikon veprime kundër organizatave të cilat "rrezikojnë sigurisë dhe vepronë kundër rendit kushtetues të Kosovës", bazuar në kërkesën e "organit kompetent për siguri". Nuk ishte kryer ndonjë hetim paraprak në lidhje me çështjen. 24 organizata mbeten të pezulluara, për shkak se vendimet e pezullimit ripërtërihen në mënyrë automatike. Nuk ekziston dëshmi e mjaftueshme për të konstatuar se ka keqtrajtim të OShC-ve në Kosovë, pasi që numri i pezullimeve si dhe organizatave të pezulluara është çdo vit i njëjtë. D-OJQ ka filluar procesin e hartimit të legjislacionit sekondar për zbatimin e Ligjit për OJQ-të. Megjithëse shoqëria civile përfaqësohet përmes grupit punues, deri më tani është zhvilluar vetëm një takim i përbashkët. Është me rëndësi që ky proces të menaxhohet mirë dhe që legjislacioni sekondar të mbetet brenda kufijve të parimeve kryesore, të përcaktuara nga legjislacioni primar.

Ligji parashikon mbrojtjen nga çfarëdo forme të ndërhyrjes në raste kur organizatat përcaktojnë aktivitetet dhe objektivat e tyre, si dhe kur rregullojnë strukturat e tyre të brendshme për të përcaktuar fushëveprimin e aktiviteteve dhe nivelin e administrimit. Në krahasim me ligjin e mëparshëm, ligji i ri përmban dispozita të veçanta për mbrojtjen e OShC-ve nga ndërhyrja e palëve të treta. Institucionet shtetërore janë të obliguara të mos cenojnë lirinë e asociimit në çfarëdo forme dhe të mundësojnë funksionimin e OShC-ve, e gjithashtu të ofrojnë mbrojtje ndaj OShC-ve në raste të ndërhyrjes nga palët e treta.

Legjislacioni i Kosovës për raportim financiar dhe rregulla të kontabilitetit nuk e merr në konsideratë karakterin specifik të OShC-ve. Kërkesat e raportimit financiar janë të dyfishta: raportimi i transaksioneve financiare dhe pasqyrave financiare vjetore tek Administrata Tatimore e Kosovës, si dhe nëse mund të aplikohen, duhet të deklarohen edhe llojet e tatimeve si në vijim: tatimi në paga, tatimi në të ardhura të korporatave, tatimi në qira/të drejta pronësore dhe kontributet pensionale. Raportimi tek Departamenti për Regjistrimin e OJQ-ve është i obligueshëm për organizatat me status për përfitim publik. Kërkesat e raportimit tek Administrata Tatimore, si dhe sanksionet për mosarritjen e përbushjes së këtyre kërkesave të raportimit nuk i marrin parasysh veçoritë e OShC-ve, por ato janë identike/proporcionale me bizneset. Vetëm organizatat me status për përfitim publik (OSPP) iu nënshtrohen kërkesave specifike të raportimit, siç është dorëzimi në baza vjetore i raporteve të tyre financiare dhe përshkruese pranë Departamentit për OJQ-të. OSPP-ve¹⁸ që kanë të ardhura më të larta se 100,000€ u kërkohet të dorëzojnë raportin e auditimit të jashtëm.

Legjislacioni për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit nuk është në përputhje me rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) dhe Direktivës së BE-së 2015/849, prandaj, janë kufizuese për OShC-të. Ligji i konsideron të gjitha OShC-të si subjekte raportuese, duke aplikuar ndaj tyre kërkesa të rrepta. Kërkesat e

¹⁷ Intervista me Departamentin për OJQ-të

¹⁸ Deri në fund të vitit 2018, numri i përgjithshëm i OSPP-ve ishte 184

tilla kërkojnë që çdo OShC të posedojë staf të certifikuar për legjislacionin për parandalimin e shpërlarjes së parave, gjithashtu OShC-të duhet t'i kontrollojnë të gjithë përfituesit e tyre si dhe çështjet tjera financiare dhe administrative. Në përputhje me rekomandimet e FATF, në vitin 2018, është kryer vlerësimi i rrezikut për sektorin e shoqërisë civile, i cili paraqiti një listë të gjatë të çështjeve problematike. Nëse ky vlerësim miratohet, atëherë kjo do të rezultonte në monitorimin dhe inspektimin e mëtejshëm të OShC-ve nga ana e komunave dhe institucioneve tjera. Organizatat e shoqërisë civile ofruan komente dhe rekomandime të hollësishme, të cilat thuajse u pranuan tërësisht nga grupi punues. Nga ana tjetër, Qeveria e vonoi miratimin e raportit të vlerësimit të rrezikut duke e bërë të pamundur që rekomandimet e këtij raporti të merren parasysh për Strategjinë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Shpërlarjes së Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019 - 2023. Si rezultat, Strategjia e miratuar në maj të vitit 2019 i klasifikoi OShC-të midis sektorëve të paktë që përfaqësojnë rrezik të lartë në financimin e terrorizmit. Grupi punues për ndryshimin e Ligjit për PSHP/LFT zhvilloi disa takime gjatë vitit 2019, si dhe u organizuan një sërë punëtorish rreth propozimit të ideve për zgjidhje midis përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe nëpunësve civilë.

OShC-të mund t'iu nënshtrohen sanksioneve materiale nëse nuk arrijnë ta njoftojnë Departamentin për OJQ-të brenda 30 ditëve, në rast se e ndryshojnë emrin, adresën, misionin dhe vizionin e organizatës së tyre, ose informatat kontaktuese. Në raste të tilla, gjocat e përcaktuara nga Ligji për OJQ-të janë 250€ për organizatën dhe 80€ për personin e autorizuar. Sidoqoftë, këto gjoba konsiderohen si proporcionale me gjendjen financiare të sektorit të shoqërisë civile në Kosovë. Një organizatë mund të vendosë që ta shuajë veprimtarinë e saj në këto rrethana: nëse merret një vendim i vullnetshëm nga organi më i lartë drejtues, në përputhje me statutin; nëse OShC-ja pëson falimentim; nëse në status ose në aktin themelues parashihet afati i shuarjes; ose në bazë të vendimit të gjykatës. Në kuadër të Ligjit për Lirinë e Asocimit në OJQ, dispozitat ligjore për shpërbërjen e OShC-ve janë në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare. Pavarësisht se ekziston një udhëzim administrativ për themelimin e komisionit për ndarjen e aseteve të mbetura të OJQ-ve të shuara, procedurat dhe kriteret specifike mbi vendimet nga ky komision nuk janë të përcaktuara qartë.

Në përgjithësi, OShC-të në Kosovë funksionojnë pa ndërhyrjen shtetërore në çështjet e tyre të brendshme. Anketa nxorri në pah se asnjë organizatë nuk ka qenë subjekt i ndonjë keqtrajtimi nga ana e Qeverisë, për shkak të kritikave të tyre.¹⁹ Gjithashtu, nuk ka pasur asnjëherë raste të raportimit të mbikqyrjes së bezdisshme, në aspektin e auditimeve të tepruara. Nga ana tjetër, asnjë OShC²⁰ nuk e ka shkelur ligjin vitin e kaluar, prandaj, ato nuk iu nënshtroan sanksioneve. Një numër i kufizuar prej katër organizatave²¹ raportuan se ishin përballur me ndërhyrjen shtetërore në çështjet e tyre të




Figura 1 Kërkesat e raportimit (përfshirë atë financiare) që kërkojnë nga autoritetet shtetërore

¹⁹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

²⁰ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

²¹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

brendshme, qoftë përmes vizitave zyrtare pa paralajmërim, kufizimeve të paarsyeshme ndaj aktiviteteve të tyre, sulmeve të kundërligjshme ndaj OShC-ve të tyre ose masave administrative diskriminuese të aplikuara kundër organizatave të tyre.

Disa OSHC raportuan për vështirësi në qasjen ndaj shërbimeve bankare. Disa banka kanë paraqitur kërkesa shtesë për OShC-të, siç është prania fizike e themeluesit të organizatës gjatë hapjes apo mbylljes së llogarisë bankare. Një organizatë grant-dhënëse²² e intervistuar, nënvizoi se "kërkesat shtesë për të hapur një llogari bankare kanë shkaktuar vështirësi për disa OJQ në lidhje me afatet tona kohore, si rrjedhojë, disa prej tyre ishin pothuajse vonë për ta pranuar grantin". Banka të ndryshme kanë caktuar tarifa të ndryshme për mirëmbajtjen e llogarive të OShC-ve. Ato janë të papërcaktuara; duke filluar prej 1-20€, të caktuara në mënyrë individuale nga secila bankë, meqë Banka Qendrore ka caktuar një kufi prej 0.99 € deri në 20€, brenda të cilit duhet të tarifohet mirëmbajtja e llogarisë. Nga këto mospërputhje, është e logjikshme të arrihet në përfundim se bankat qëllimisht janë duke e refuzuar qasjen ndaj shërbimeve të tyre për OJQ, sipas të ashtuquajturave "politika për eliminimin e riskut", për shkak të kategorizimit të sektorit të shoqërisë civile si të cenueshëm ndaj financimit të terrorizmit.

1.1.3. Sigurimi i burimeve financiare

Krijimi i mjedisit të favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

OShC-ve u lejohej të angazhohen në aktivitete ekonomike, për të mbështetur veprimet e tyre që duhet të jenë në përputhje me parimin jo - përpëfitim. Legjislacioni ia mundëson OShC-ve të angazhohen në aktivitetet ekonomike në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes posedimit të pronës dhe asetëve. Të ardhurat e gjeneruara nga aktivitetet e tilla duhet të shfrytëzohen vetëm për qëllime që kanë të bëjnë me misionin e organizatës.

Financimi i organizatave, veprimtaria e të cilave nuk është në pajtueshmëri me rendin ligjor dhe ligjin ndërkombëtar është i ndaluar. OShC-ve u lejohej gjithashtu të shfrytëzojnë burime të jashtme dhe private të financimit, teksa legjislacioni në fuqi nuk e ndalon këtë në çfarëdo forme. Ligji për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit përmbante dispozita ku OShC-të detyroheshin të kërkonin leje para se të pranonin fonde nga jashtë, qoftë në para të gatshme apo përmes transferit bankar, por pas ndryshimit të ligjit këto kufizime u shfuqizuan. Ligji për Lirinë e Asocimit në OJQ lejon ngritjen e fondeve pa kufizime nga individët, korporatat dhe burimet tjera.

²² Intervista me Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim, 31 tetor 2019

Në praktikë, ka një rritje të lehtë të OShC-ve që janë të angazhuara në aktivitet ekonomik, krahasuar me 88% të OShC-ve²³ që potencuan se nuk ishin angazhuar në vitin 2016. Nga 22% të OShC-ve²⁴ që këtë vit kanë pasur aktivitet ekonomik, shumica prej tyre nënvizuan se nuk janë përballur me ndonjë vështirësi. Pjesa tjetër e OShC-ve theksuan nevojën e thjeshtësimit të procedurave të tatimit dhe kontabilitetit, si dhe të rregullave të monitorimit dhe vlerësimit. Në mesin e vështirësive u rradhitën edhe kërkesat e rrepta dhe të tepruara. Sipas gjetjeve nga hulumtimi, donatorët e huaj janë burimi më i madh i financimit për




Figura 2 Përvojat e OShC-ve që angazhohen në aktivitete ekonomike

OShC-të e Kosovës, me 41%. BE-ja dhe shumica e donatorëve dypalësh janë të liruar nga TVSH-ja, sikurse edhe mallrat dhe shërbimet për qëllime humanitare. Megjithatë, vetëm 5%²⁵ e donatorëve janë të liruar nga TVSH-ja, krahasuar me 30%²⁶ të OShC-ve. Financimi nga burimet private mbetet një burim i paqëndrueshëm i financimit për shoqërinë civile në Kosovë. Më pak se 20%²⁷ e organizatave të anketuara theksuan se kanë pranuar donacione nga kompanitë private dhe donatorët individualë. Nuk është raportuar për ndonjë vështirësi në lidhje me procedurat e komplikuar administrative.

Kutia 1: Vlerësimi i udhëzuesit të BE-së për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit

Objektivi 1. Rezultati 1.1.a; 1.1.b; 1.1.c. Liria e asociimit është e drejtë kushtetuese që gjithashtu garantohet me Ligjin e Lirisë së Asociimit në OJQ. Ky Ligj është ndryshuar gjatë vitit 2019 duke i plotësuar më shumë parimet dhe standartet e lirisë së asociimit, në përputhje me standartet dhe praktikat ndërkombëtare. Legjislativi i PSHP/LFT akoma e konsideron sektorin e SHC si një subjekt raportues, ndërsa për herë të parë në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji i ri për Ndërmarrjet Sociale.

Objektivi 1. Rezultati 1.3.a. Korniza ligjore nuk përmban dispozita rreth themelimit dhe funksionimit të organizatave me bazë në komunitet. Sidoqoftë, korniza ligjore njih të drejtën për ta ushtruar lirinë e asociimit pa e regjistruar organizatën.

²³ Matrica e monitorimit mbi krijimin e mjedisit të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile. Raporti për Kosovën 2016

²⁴ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

²⁵ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

²⁶ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

²⁷ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

Nën-fusha 1.2. Liritë e ndërlidhura

1.2.1. Liria e tubimit paqësor

Mjedisi i favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Liria e tubimit në Kosovë është e drejtë kushtetuese, e garantuar me nenin 43 të Kushtetutës. Përveç kësaj, Ligji 03/L-118 për Tubimet Publike u garanton të gjithë qytetarëve të Kosovës të drejtën për të organizuar dhe për të marrë pjesë në tubime publike.

OShC-të gëzojnë të drejtën e lirisë së tubimit, qoftë në mënyrë individuale ose përmes organizatës së tyre, ndërsa procedurat administrative konsiderohen të lehta për t'u zbatuar. Korniza ligjore kërkon njoftimin paraprak për tubimet publike, përveç në raste kur nuk nevojiten masat shtesë të sigurisë. Autoritetet publike duhet të njoftohen 72 orë përpara, teksa duhet të sigurohen të gjitha parakushtet e kërkuara me ligj për të organizuar një tubim publik.

Në raste kur nuk jepet përgjigje në kohën e duhur (48 orë para tubimit publik) nga ana e autoriteteve, tubimi publik mund të zhvillohet pa ndonjë kufizim. Nëse vendimi për ta ndaluar tubimin konsiderohet si i padrejtë, ligji lejon që organizatori i tubimit të paraqesë ankesë pranë policisë brenda 48 orëve. Pastaj, nëse vendimi konsiderohet i pakënaqshëm, Ligji garanton të drejtën e apelimit në gjykatë brenda tre ditëve përmes procedurës së përsheptuar.

Megjithatë, dispozitat ligjore iu referohen vetëm qytetarëve të Kosovës. Mbetet e paqartë nëse liria e tubimit vlen edhe për personat pa shtetësi, refugjatët, shtetasit e huaj dhe të tjerët. Tubimet e paplanifikuara dhe kundërtubimet nuk lejohen, megjithëse Ligji nuk e thekson në mënyrë të qartë. Ligji përcakton se kërkesa për të organizuar një tubim mund të refuzohet nëse në një kohë dhe vend të përafërt ose të njëjtë është dhënë ndonjë leje tjetër për ndonjë tubim tjetër. Korniza ligjore nuk ka pësuar ndryshim gjatë vitit të kaluar. Në vitin 2019, Ministria e Punëve të Brendshme inicioi procesin e hartimit të Ligjit për Tubime Publike. Aktualisht, projektligji ka kaluar fazën e konsultimit publik në internet, ndërsa duket se nuk i trajton sferat problematike të identifikuara nga OShC-të.

Anketa nxorri në pah se 52% e OShC-ve²⁸ kanë marrë pjesë në një tubim publik: parakalim, protestë ose demonstrim në ambient të hapur, qoftë në mënyrë individuale ose përmes organizatës së tyre. Kurse 24%²⁹ e organizatave kanë organizuar vetë tubimet publike. Të dyja grupet raportuan se nuk ka pasur ndonjë kufizim gjatë organizimit apo pjesëmarrjes në tubime publike. Në mënyrë të ngjashme, OShC-të e intervistuar³⁰ ishin të specializuara në monitorimin e lirisë së tubimit publik në Kosovë.

Të dhënat e siguruar nga Policia e Kosovës tregojnë se në vitin 2019, leja ishte dhënë për 532 tubime publike, ndërsa vetëm shtatë prej tyre ishin ndaluar. Tre nga shtatë tubimet e kufizuara publike u shoqëruan me një shpjegim me shkrim. Nuk është apeluar në polici për tubimet e ndaluara apo të kufizuara³¹.

Përgjatë viteve ka pasur rritje të konsiderueshme të protestave të organizuara nga qytetarët për ta shprehur mendimin e tyre në lidhje me çështjet si mbrojtja e mjedisit, kërkesa për standarde më të mira të jetesës ose shfaqja e pakënaqësisë me reformën arsimore në Kamenicë. Raportet e mediave tregojnë³² se policia ushtroi dhunë kundër protestuesve të Bitisë, të cilët kishin kundërshtuar ndërtimin e hidrocentralit në fshatin e tyre. Disa qytetarë, përfshirë disa fëmijë, u lënduan gjatë aksionit policor. Nuk është raportuar për ndonjë

²⁸ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

²⁹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

³⁰ Intervista me Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, 18 maj 2020

³¹ Kërkesa për qasje në informata publike të Policisë së Kosovës, 14 maj 2020

³² <https://www.koha.net/kosove/187964/dhjetera-te-lenduar-nga-intervenimi-i-policise-ne-protesten-ne-shterpece-kunder-hidrocentralit/>

protestë tjetër ku është ushtruar dhunë nga policia. Përkundër faktit se është e ndaluar me ligj, vitin e kaluar anëtarët e katër OShC-ve morën pjesë në një kundërtubim. Ata raportuan se ishte siguruar mbrojtja nga policia. Gjatë protestës #Riseup4Rojava, në solidaritet me popullin kurd, ishte organizuar një kundërprotestë në lokacion të afërt. Një grup i njerëzve e kundërshtoi protestën, megjithatë, nuk u raportua për ndonjë incident. Statistikat e siguruar nga Policia e Kosovës³³ tregojnë se nuk është ndaluar asnjë kundërtubim, ndërsa gjashtë tubime të paplanifikuara janë shpërndarë për shkak të mungesës së njoftimit. Gjatë vitit 2019³⁴, u shpërndanë gjithsej nëntë tubime publike. Vitin e kaluar, rojet e sigurimit të një partie politike dhe përfaqësues e aktivistë të shoqërisë civile u përplasën ndërmjet veti, ndërsa këta të fundit protestonin kundër projektligjit për financimin e partive politike.

Tri organizata nga gjithsej 52³⁵ që morën pjesë në tubime publike deklaruan se mediat ishin të kufizuara për të marrë pjesë në tubime të tilla. Gjithashtu, statistikat e siguruar nga zyra e marrëdhënieve me publikun në kuadër të Policisë së Kosovës pohojnë se në një tubim publik ishte ushtruar dhunë, ndërsa tetë protestues u arrestuan gjatë vitit 2019.

1.2.2. Liria e shprehjes

Mjedis i favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Liria e shprehjes është e drejtë kushtetuese, e bazuar me nenin 40, i cili garanton lirinë e shprehjes për të gjithë, dhe mund të kufizohet vetëm nëse është e domosdoshme për të parandaluar dhunën ose urrejtjen racore, etnike ose fetare. Nuk ekziston ndonjë ligj i veçantë që ka të bëjë veçanërisht me lirinë e shprehjes, mirëpo një sërë ligjesh përmbajnë dispozita që lidhen me të, siç janë: Ligji Civil kundër Shpifjes, Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve, Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale etj. Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve dhe Ligji për Qasje në Dokumente Publike janë ndryshuar në dy vitet e fundit.

I pari është shfuqizuar me Ligjin e ri nr. 06 / L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i cili paraqiti këto ndryshime: zëvendësoi termin 'informator' me 'sinjalizues', shtoi mbrojtjen duke filluar prej punëdhënësit e deri tek praktikantët, vullnetarët, kursistët dhe çdo person tjetër që ofron ndihmë të çfarëdo lloji ndaj një sinjalizuesi. Ligji njih tri lloje të sinjalizimeve: të brendshme, të jashtme dhe publike. Sinjalizuesi nuk mund të jetë subjekt i përgjegjësisë penale ose civile apo procedurave disiplinore. Përveç kësaj, ligji i obligon institucionet publike që kanë më shumë se 15 të punësuar dhe ato private që kanë më shumë se 30 të punësuar, të caktojnë personelin përgjegjës për sinjalizim. Pavarësisht se legjislacioni primar është në favor të lirisë së shprehjes, qeveria është duke e zvarritur procesin e hartimit të legjislacionit sekondar, i cili do të përcaktonte procedurat për trajtimin e një sinjalizuesi.

Ndërsa, Ligji për Qasje në Dokumente Publike ka detajuar tutje procedurat për të siguruar qasje në dokumente publike, siç është përditësimi dhe publikimi në mënyrë proaktive i listave të dokumenteve që janë në dispozicion të institucionit. Korniza e përcaktuar ligjore nuk përmban dispozita që do të kërkonin leje për të folur, për të mbajtur prezantime/ligjërata në publik, e as ndonjë kërkesë për domosdoshmërinë e aprovimit të publikimeve të organizatave. Ekspertët vendorë të mediave e kanë vlerësuar lirinë e shprehjes si të favorshme. Sidoqoftë, zbatimi i saj është i ngadaltë, kryesisht i shkaktuar nga mungesa e mekanizmave mbështetës.

Gjatë vitit 2019 u shënuan dy raste të institucioneve publike, të cilat inicuan hartimin e politikave që do të cenonin lirinë e shprehjes. Në rastin e parë, Këshilli Prokurorial i Kosovës

³³ Kërkesa për qasje në informata publike të Policisë së Kosovës, 14 maj 2020

³⁴ Kërkesa për qasje në informata publike të Policisë së Kosovës, 14 maj 2020

³⁵ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

miratoi një Rregullore për komunikim me publikun, i cili ndalon zyrtarët e vet të komunikojnë me media dhe gazetarë në lidhje me "zhvillimet e veçanta", përveç nëse kryeprokurori njoftohet paraprakisht. Rregullorja nuk saktëson se çfarë zhvillimi përbën një "zhvillim i veçantë". Në rastin e dytë, Komisioni i Pavarur për Media inicioi hartimin e politikave që ndalon raportimin e vendimeve të gjykatës për zyrtarët publikë deri në vendimin përfundimtar. Në momentin që kjo politikë doli në konsultim publik, mediat dhe shoqëria civile parashtruan komentet e tyre për të adresuar dispozitat problematike.

Siç përshkruhet më lart, të gjitha rastet e kufizimeve të lirisë së shprehjes janë të përcaktuara qartë dhe janë në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Vitet e fundit janë karakterizuar me një rritje të sulmeve ndaj gazetarëve, e kjo supozohet se ka të bëjë me mungesën e mbrojtjes institucionale. Institucionet përgjegjëse nuk janë duke u përpjekur sa duhet për t'i zgjidhur rastet e sulmeve ndaj gazetarëve. Hetimet vonohen dhe/ose janë të ndikuara nga palët e treta, duke rezultuar në një përqindje të ulët të çështjeve të zgjidhura dhe dënime të shkurtra. Në këtë aspekt, Gjykata Themelore e Prishtinës ka emëruar rishtazi një koordinator në tentimin për ta rritur përqindjen e zgjidhjes së rasteve në lidhje me sulmet ndaj gazetarëve. Koordinatorë të tillë janë emëruar edhe nga Zyra e Prokurorit të Shtetit dhe nga Zyra e Prokurorisë Themelore. Efikasiteti i këtyre emërimeve të fundit ende nuk është vlerësuar. Kodi penal u ndryshua në vitin 2019, ndërsa shpifja vazhdon të konsiderohet si kundërvajtje sesa pjesë e kodit pënal. Në përgjithësi, Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes nuk përmban dispozita të tepruara mbrojtëse ndaj zyrtarëve shtetërorë.

Të dhënat e anketës tregojnë se, në përgjithësi, OShC-të në Kosovë gëzojnë lirinë e shprehjes. Më shumë se 80%³⁶ e të anketuarve pohuan se ndaj tyre nuk ishte ushtruar ndonjë presion gjatë përdorimit të gjuhës kritike apo kur kritika e tyre synonte autoritetet shtetërore. Nëntëdhjetetë përqind³⁷ e OShC-ve raportuan se nuk ishin sulmuar apo bllokuar gjatë përdorimit të mjeteve të komunikimit në internet, ndërsa 90%³⁸ e OShC-ve deklaruan se nuk ishin kërcënuar për shkak të opinionëve të tyre kritike. Nuk ka pasur raste të raportuara nga OShC-të³⁹ në lidhje me sanksionimin ose burgosjen për shkak të raportimit me përmbajtje kritike. Përfaqësuesit e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës⁴⁰ theksuan se nuk kishin vërejtur raste të individëve ose përfaqësuesve të OShC-ve që iu janë nënshtruar autocensurës. Sidoqoftë, vështruar nga këndi i mediave dhe gazetarëve liria e shprehjes nuk zbatohet në nivelin e duhur. Një gazetarit iu refuzua hyrja në hapësirat e Kuvendit të Kosovës për shkak të mos akreditimit. Megjithatë, atëkohë asnjë prej mediave nuk ishte akredituar, për shkak të vonësve brenda administratës së Kuvendit. Në një rast tjetër, drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror nxiti personelin e saj ta ndërprisnin komunikimin me një gazetar. Ai deklaroi se nuk i pëlqente raportimi investigativ i gazetarit. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës raportoi⁴¹ se në vitin 2018, 16 gazetarë investigativ u kërcënuan ose u keqtrajtuan, si nga akterët shtetërorë ashtu edhe nga ata joshetërorë. Këtu përfshihen zyrtarët e komunës, biznesmenët dhe disa raste të sulmeve nga qytetarët. Raporti i Freedom House⁴² i vitit 2020 e rradhit Kosovën si pjesërisht të lirë, ndërsa raporti i Reporters Without borders 2019⁴³ tregon për një rritje në renditjen e Kosovës, në krahasim me vitin e kaluar, nga vendi i 75 në 78.

³⁶ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

³⁷ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

³⁸ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

³⁹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁴⁰ Intervista me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës, 28 maj 2020

⁴¹ <http://agk-ks.org/wp-content/uploads/2018/12/Summary-of-the-findings-Indicators-on-the-level-of-media-freedom-and-journalists-safety-Kosovo-2018.pdf>

⁴² <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2020>

⁴³ <https://rsf.org/en/kosovo>

1.2.3. Qasje në informata

Mjedisi i favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Organizatat e shoqërisë janë të lira të kenë qasje në burime të informatave dhe u lejohej të pranojnë dhe përçojnë informata përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit. Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe EUROSTAT tregojnë se në vitin 2018, 93% e banorëve kishin qasje në internet në shtëpitë e tyre.

Mundësia për të komunikuar dhe për të pasur qasje në informata, përfshirë internetin dhe TIK, garantohet me Ligjin për Komunikimet Elektronike, i miratuar në vitin 2012. Ligji për Monitorimin e Komunikimeve Elektronike u miratua në vitin 2015, teksa përfaqësuesit e shoqërisë civile morën pjesë në hartimin e tij. Ky ligj ndalon monitorimin e paarsyeshëm të kanaleve të komunikimit, përveç monitorimit në bazë të vendimit të gjykatës, pas dëshmimit se të gjitha mjetet tjera investigative janë shterur. Ligji përmban një sërë mekanizmesh të zhvilluara të kontrollit për të siguruar që çdo monitorim i komunikimeve elektronike është i ligjshëm, siç janë gjykatat, komisionet parlamentare, Institucioni i Avokatit të Popullit etj.

Nëntëdhjeteshtatë përqind⁴⁴ e OShC-ve të anketuara nënvizuan se nuk kanë pasur kufizime të qasjes në burime të informatave, përfshirë faqet e internetit ose platformat e komunikimit në internet. Asnjë prej organizatave të anketuara⁴⁵ nuk raportoi për ndonjë monitorim të paligjshëm nga ana e autoriteteve. Përveç kësaj, asnjë prej OShC-ve⁴⁶ nuk ka raportuar të jetë përballur me keqtrajtim nga policia, për shkak se i përkasin grupeve të veçanta të rrjeteve sociale.

Kutia 2: Vlerësimi i udhëzuesit të BE-së për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit

Objektivi 1. Rezultati 1.1.a; 1.1.b; 1.1.c. Liria e tubimit dhe liria e shprehjes garantohen me Kushtetutën e Kosovës. Korniza ligjore e lirisë së tubimit në përgjithësi është pozitive, përveç që nuk i pranon kundërtubimet, pra, është e paqartë nëse shtetasit e huaj kanë të drejtë të organizojnë tubime. Ekzistojnë disa ligje që rregullojnë lirinë e shprehjes, që në përgjithësi janë favorizuese, përkundër faktit që iu mungojnë mekanizmat për të siguruar zbatimin e efektshëm.

⁴⁴ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁴⁵ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁴⁶ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

Fusha 2: Korniza për zbatueshmëri dhe qëndrueshmëri financiare të OShC-ve

Nën-fusha 2.1. Trajtimi tatimor/fiskal për OShC-të dhe donatorët e tyre

2.1.1. Lehtësirat tatimore

Mjedis pjesërisht i favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Nuk ka pasur ndonjë ndryshim të fundit në kornizën ligjore që përfshinë përfitimet tatimore për OShC-të. Një sërë burimesh financiare të OShC-ve janë të liruara nga tatimet, si grantet, donacionet dhe subvencionet, bazuar në Vendimin Shpjegues të publikuar nga ATK-ja në vitin 2016. Korniza ligjore mbi veprimtaritë ekonomike vazhdon të mbetet e paqartë, veçanërisht në lidhje me veprimtaritë ekonomike të OShC-ve të cilat nuk e gëzojnë statusin për përfitim publik. Sipas ATK-së, veprimtaritë ekonomike/komerciale të OSPP-ve lirohen nga tatimi në të ardhura të korporatës, nëse destinacioni i të ardhurave është vetëm për qëllime të përfitimit publik dhe deri në një "nivel të arsyeshëm" të të ardhurave. Përderisa ky nen përmend vetëm OSPP-të, një tjetër nen për veprimtaritë komerciale i referohet të gjitha OShC-ve të regjistruara "veprimtaria komerciale ose ndonjë veprimtari tjetër e të cilave duhet të jetë e lidhur vetëm me qëllimet e tyre publike deri në një nivel të arsyeshëm të të ardhurave". Kjo nënkupton që veprimtaria ekonomike e çdo OShC-je të regjistruar duhet të lidhet drejtpërdrejt me misionin e saj dhe të ardhurat duhet të jenë deri në një nivel të arsyeshëm, ndërsa të gjitha veprimtaritë tjera ekonomike i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat. Kjo mospajtuueshmëri shkakton vështirësi në interpretim dhe zbatim. Korniza ligjore në fuqi argumenton se kuptimi i termit "niveli i arsyeshëm i të ardhurave" duhet të përcaktohet përmes legjislationit sekondar, i cili nuk është hartuar asnjëherë. Në vitin 2016, Ministria e Financave njoftoi në lidhje me planet për të funksionalizuar investimet pasive duke shfrytëzuar të ardhurat e gjeneruara nga procesi i privatizimit. Megjithatë, në fund të po të njëjtit vit, qeveria hoqi nga programi i saj legjislativ hartimin e ligjit për investime pasive. Hartimi i këtij ligji nuk ka qenë pjesë e programit legjislativ në vitet pasuese. Ministria nuk i kishte saktësuar qëllimet e shrytëzimit të investimeve të tilla. Nuk ekziston ndonjë kornizë ligjore lidhur me themelimin ose funksionimin e fondeve investive/të dhurimeve në Kosovë. Nuk ekzistojnë as politikat të cilat parashikojnë përfitimet tatimore për to.

Sikurse viteve të mëparshme, asnjë prej OShC-ve⁴⁷ nuk ka raportuar për ndonjë tatim të drejtpërdrejtë

ose të tërthortë për grante apo donacione.

Burimet tjera të financimit dhe përfitimet tatimore janë të pazakonta. Tetë përqind⁴⁸ e

OShC-ve pohuan se veprimtaria ekonomike

ishte burimi i tyre i financimit, megjithëse asnjë prej tyre nuk kishte pranuar përfitime tatimore. Investimi pasiv ka qenë burim i fondeve për 6%⁴⁹ të OShC-ve, teksa dy OShC dhe dy organizata donatore kanë qenë të liruara nga tatimi.

Megjithatë, forma e kthimit të mjeteve financiare vjetore nuk përmban ndonjë kategori të veçantë të të ardhurave nga investimet pasive. OShC-të i konsiderojnë procedurat e sigurimit të përfitimeve tatimore si të vështira. Më shumë se 40%⁵⁰ e OShC-ve i vlerësojnë procedurat si të vështira ose deri diku të vështira, ndërsa vetëm 11%⁵¹ e OShC-ve mendojnë se përdorimi i tyre është i thjeshtë. Kompleksiteti i procedurave të tilla mund të jetë një nga arsyet e përqindjes së ulët të organizatave që kanë pranuar përfitime tatimore.




Figura 3 Procedura e përfitimeve tatimore

2.1.2. Lehtësirat tatimore për dhurimet individuale dhe të korporatave

Mjedis pjesërisht i favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Nuk ka pasur ndonjë ndryshim në legjislacionin tatimor në lidhje me stimulimet tatimore për donacionet e korporatave dhe individëve, përkatësisht që nga viti 2010 dhe 2015. Ligjet për Tatimin në të Ardhurat Personale dhe Tatimin në të Ardhurat e Korporatave ofrojnë 10% të zbritjes së të ardhurave të tatueshme të individëve, korporatave dhe burimeve tjera, nëse këto donacione i kushtohen qëllimeve humanitare, shëndetësore, arsimore, fetare, shkencore, kulturore, të mbrojtjes mjedisore apo atyre sportive. Pranuesit që i plotësojnë kushtet e donacioneve të tilla janë OShC-të dhe çdo organizatë jo-komerciale që vepron drejtpërdrejt në fushat e lartpërmendura. Dispozitat për OShC-të në Ligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave mbeten të paqarta dhe nuk është e kuptueshme nëse lirimet nga tatimet standarde të korporatës vlejnë për të gjitha OShC-të apo vetëm për ato me status për përfitim publik.

Në gjysmën e parë të vitit 2017, hyri në fuqi Ligji për Sponsorizimet në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Ligji, i cili nuk i përmend në mënyrë specifike OShC-të midis përfituesve që lirohen nga tatimi, klasifikon vetëm aktivitetet që kualifikohen për lirim nga tatimi. Ky ligj, duke u bazuar në tatimin në të ardhurat e korporatave, parashikon lirimin nga tatimi në të ardhurat prej 20%, për aktivitetet lidhur me rininë dhe kulturën. Për më tepër, të ardhurat nga sponsorizimet janë të liruara nga të gjitha tatimet. Prej informatave të ofruara më lartë, mund të konstatohet se korniza ligjore përfshinë dispozita pozitive në lidhje me përfitimet tatimore për donacionet, veçanërisht për ato private. Ligjet për tatimin mbi të ardhurat e korporatave dhe atyre personale ofrojnë një zbritje prej 10% të tatimeve për

⁴⁷ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁴⁸ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁴⁹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁵⁰ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁵¹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

donacionet, vetëm për një numër të kufizuar të aktiviteteve të përfitimit publik. Lista është shumë më e shkurtër se lista e aktiviteteve të përfitimit publik, që përcaktohen me Ligjin e ri për OJQ-të. Këto aktivitete të përfitimit publik përfshijnë organizatat që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe të drejtat e konsumatorit, ato që mbështesin praktikat demokratike dhe shoqërinë civile dhe ato që ndihmojnë refugjatët. Kjo nënkupton se statusi për përfitim publik nuk luan ndonjë rol në qasjen ndaj përfitimeve tatimore, duke e bërë legjislacionin fiskal joracional me statusin për përfitim publik të Ligjit për OJQ-të.

Përgjegjësia sociale e korporatave nuk është një koncept i zakonshëm midis kompanive private në Kosovë, dhe si koncept nuk promovohet nga shteti. Si rrjedhojë, nuk ekzistojnë dokumente të hartuara të politikave në lidhje me këtë çështje.

Sikurse është theksuar në raportet e mëparshme, asnjë prej OShC-ve⁵² nuk ka raportuar të kenë përfituar nga zbritjet e tatimeve për donacionet e tyre individuale dhe të korporatave. Sidoqoftë, nuk është raportuar për ndonjë rast të kufizimeve për llojet e OShC-ve që mund të pranojnë donacione të zbritshme nga tatimet. Kur u kërkua nga to që të vlerësojnë procedurat e lirimit nga tatimi për dhurimet e donatorëve, 58% e OShC-ve të anketuara u përgjigjën se nuk kanë njohuri në lidhje me kornizën ligjore ose ekzistencën e procedurave të tilla. Pesë organizata u përgjigjën se nuk ekzistojnë stimulimet tatimore për donatorët, ndërsa vetëm 14% të OShC-ve i vlerësuan ato si mjaft inkurajuese ose gjithëpërfshirëse.

Kutia 3: Vlerësimi i udhëzuesit të BE-së për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit

Objektivi 2. Rezultati 2.1.a; 2.1.b; 2.1.c. Korniza ligjore për rregullat e raportimit dhe trajtimin tatimor/fiskal nuk ndryshoi në vitin 2019. Rregullat financiare dhe kërkesat e raportimit për OShC-të janë identike me ato të bizneseve, të cilat në përgjithësi zbatojnë parimin e proporcionalitetit, por konsiderohen të komplikuar nga OShC-të.

Objektivi 2. Rezultati 2.3.a; 2.3.b. Një sërë burimesh të donacioneve të OShC-ve janë të lira nga tatimet, megjithatë ka paqartësi nëse aktiviteti ekonomik i një OShC-je pa SPP lirohet nga tatimi i korporatave. Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale dhe Ligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatës ofrojnë 10 për qind zbritje.

Nën-fusha 2.2. Përkrahja shtetërore

2.2.1. Disponueshmëria e financimit publik

Mjedis pjesërisht i favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Viti 2019 shënon vitin e tretë të zbatimit të Rregullores MF-NR-04/2017 që rregullon kriteret, standardet dhe procedurat për ndarjen e fondeve publike për OShC-të. Zbatimi i kësaj rregulloreje është i detyrueshëm për institucionet e nivelit qendror dhe lokal. Është dokumenti i parë i këtij lloji që rregullon ndarjen e fondeve publike për OJQ, bazuar në kriteret, standarde dhe procedura unike. Rregullorja u nënshkrua pas një bashkëpunimi të ngushtë midis zyrtarëve publikë dhe shoqërisë civile. Ndërkohë, Strategjia për bashkëpunimin Qeveri – OShC për periudhën 2019 - 2023 parashikon zhvillimin e një skeme të bashkëfinancimit për fondet e BE-së për OShC-të.

Rregullorja ka zhvilluar sistemin e decentralizuar të ndarjes së fondeve publike ku secili

⁵² Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

institucion publik është përgjegjës për ndarjen e fondeve të veta, në përputhshmëri me objektivat strategjike dhe fushëveprimin e tyre. Rregullorja kërkon që fondet publike për organizata joqeveritare të planifikohen përmes linjave të veçanta buxhetore në kuadër të buxhetit vjetor të shtetit. Pas kërkesës, Ministria e Financave formon kode të veçanta buxhetore për secilin institucion publik që ka për qëllim ndarjen e fondeve publike. Kjo ka të bëjë me planifikimet e buxhetit vjetor ku kërkesat tejkalojnë buxhetin e parashikuar. Prandaj, Ministria e Financave merr vendimin përfundimtar rreth fushave prioritare që duhet të mbështeten. Sidoqoftë, që nga hyrja në fuqi e Rregullores, kode të tilla nuk u formuan. Si rrjedhojë, buxheti vjetor i shtetit për vitin 2019 nuk përfshinë linja të veçanta buxhetore për financim të organizatave joqeveritare, megjithëse ekzistojnë disa linja të përbashkëta buxhetore si shërbimet kulturore, rinia dhe sporti, si dhe çështjet e barazisë gjinore. Disa komuna si Rahoveci dhe Istogu kishin linja buxhetore për financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve të OShC-ve.

Ligji 04/L-080 për Lojërat e Fatit lejon ndarjen e një shume të caktuar të parave nga Fondi i Lotarisë së Kosovës, që mund të përdoret për financimin e kategorive sociale, çështjeve të drejtave të njeriut, kulturës dhe sportit. Detajet e transferimeve të tilla kanë mbetur të përcaktohen përmes legjislacionit sekondar. Megjithatë, nga mesi i vitit 2019, Ligji për Lojërat e Fatit u shfuqizua nga Qeveria e Kosovës duke i anuluar kështu dispozitat ligjore për financimin eventuale të shoqërisë civile nga fondet e Lotarisë.

Sipas Rregullores, çdo ofrues i fondeve publike është i detyruar ta bëjë planifikimin në kuadër të buxhetit vjetor të shtetit, në përputhje me prioritetet dhe objektivat e tyre strategjike dhe në konsultim me organizatat e shoqërisë civile. Rregullorja specifikon që komisioni për vlerësim duhet të përbëhet nga pesë anëtarë, njëri prej të cilëve duhet të jetë përfaqësues nga shoqëria civile, i zgjedhur përmes thirrjes publike.

Sipas rezultateve të anketës, 37⁵³ OSHC kanë pranuar fonde publike. Shumica e fondeve të pranuar ishin grante për aktivitete ose projekte specifike, ndërsa pesë OSHC kanë pranuar grante institucionale. Një organizatë ka pranuar fonde për bashkë-financim për projektet e BE-së. Në bazë të përvojave të organizatave të tyre, rreth 70%⁵⁴ e të anketuarve e konsiderojnë financimin publik si të pamjaftueshëm për t'i plotësuar nevojat e tyre. Sistemi i ndarjes së fondeve publike në Kosovë është i decentralizuar, sikurse vihet në dukje nga publikimi i Raportit gjithëpërfshirës vjetor të ZKM/ZQM në të cilin shpallet lista e përfituesve dhe shuma e ndarë e fondeve, nga secili institucion publik. Raporti i ZKM/ZQM nënvizon nevojën për të funksionalizuar sistemet e monitorimit dhe vlerësimit të ofruesve të fondeve publike. Institucionet publike ende nuk kanë arritur t'i integrojnë linjat e veçanta buxhetore për mbështetjen e OShC-ve në buxhetin vjetor, edhe pse kjo është e obligueshme. Sidoqoftë, raporti i Qeverisë për fondet publike të ndara për OShC-të ofron qasje në shumat e shpërndara tek OShC-të. Ky raport tregon se në vitin 2018, për OShC-të janë ndarë 24 milion €, në raport me 1.8 miliardë € të buxhetit të gjithëmbarshtëm vjetor. Kur KCSF-ja i përpunoi dhe analizoi listat e përfituesve, rezultoi se




Figura 4 OShC-të që kanë pranuar fonde publike

⁵³ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁵⁴ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

nga 24 milion € të raportuara si mbështetje financiare publike për OShC, në fakt, vetëm 9 milion € iu ishin ndarë organizatave të shoqërisë civile. Pjesa tjetër iu ishte ndarë federatave, klubeve sportive, operatorëve ekonomikë dhe shërbimeve të ofruara nga OSHC-të në emër të institucioneve shtetërore. Mesatarisht, një organizatë e shoqërisë civile pranoi grant në vlerë prej 9,731.71 €.

Listat e përfituesve të fondeve publike nxjerrin në pah se institucionet publike i kategorizojnë fondet e ndara për klubet dhe federatat sportive, institucionet fetare, shkollat private, ansamblet artistike dhe teatrot e qytetit, si mbështetje financiare publike dhënë për organizatat e shoqërisë civile. Vetëm për këto subjekte janë ndarë 7 milion euro si mbështetje financiare publike, ndërkaq për organizata joqeveritare janë ndarë pak më shumë 9 milion euro. Nga ana tjetër, 1 milion € u ndanë për organizatat e veteranëve/të dalura nga lufta pa hapur thirrje publike, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga rregullorja për ndarjen e fondeve publike. Përkundër faktit se mbështetja financiare publike e ndarë për organizata të shoqërisë civile është në rritje nga viti në vit (16 milion € në vitin 2017, krahasuar me 24 milion € në vitin 2018), prapëseprapë, pas analizimit të listave të përfituesve, rezulton se ka një rënie në përqindjen e fondeve publike të ndara për OShC-të. Në vitin 2017, nga totali i deklaurar në raportin e ZKM/ZQM vetëm 42 përqind e e atyre fondeve publike u ndanë për organizatat e shoqërisë civile, në krahasim me 38 përqind sa ishte në vitin 2018.

Pas hyrjes në fuqi të Rregullores për ndarjen e fondeve publike për OShC-të, institucionet publike janë më të angazhuara për të rritur disponueshmërinë e fondeve publike për OShC-të. Megjithatë, mbetet shumë për t'u ndërmarrë në aspektin e shtimit të transparencës dhe avancimit të sistemeve të monitorimit dhe raportimit. Komisioni për vlerësim duhet të përbëhet nga tre përfaqësues të institucioneve publike dhe dy ekspertë të jashtëm, njëri prej të cilëve duhet t'i përket shoqërisë civile. Anëtarët e komisionit për ankesa caktohen me vendimin e kryeshefit ekzekutiv/kreut të institucionit. Nuk saktësohet nëse përfaqësuesit e shoqërisë civile duhet të kenë ndonjë funksion. Nga pesë institucionet që ndajnë pjesën më të madhe të fondeve publike për OShC-të në nivel qendror, dy prej tyre nuk kanë shpallur thirrje publike për ekspertë të jashtëm për t'iu bashkuar komisionit për vlerësim. Mirëpo, në nivel lokal, asnjë prej komunave nuk ka shpallur ndonjë thirrje publike në internet për anëtarët e komisionit për vlerësim. Vetëm 30%⁵⁵ e organizatave të shoqërisë civile theksuan se ishin ftuar për të marrë pjesë në takime, gjatë të cilave janë caktuar prioritetet e financimit publik.

2.2.2. Shpërndarja e financimit publik

[Mjedisi i favorshëm](#) është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Rregullorja në fuqi përcakton tërë procesin e ndarjes së fondeve publike përmes caktimit të kriterëve dhe udhëzimeve të harmonizuara si dhe dokumentet për aplikim që duhet të dorëzohen. Thirrja duhet të publikohet në faqen e internetit të secilit ofrues dhe duhet të mbetet e hapur për të paktën 15 ditë pune. Për ta rritur konkurrencën dhe zgjeruar shtrirjen, inkurajohet aplikimi i mënyrave alternative të komunikimit. Përveç kriterëve të përgjithshme, siç është certifikata e regjistrimit të OShC-së dhe numri fiskal, çdo thirrje duhet të përmbajë kriterë specifike, duke u bazuar në objektivat dhe fushëveprimin e secilit institucion publik. Udhëzimet dhe formularët për aplikim duhet të publikohen në internet në formë të pakos, në momentin e publikimit të thirrjes. Komponentët e mëposhtëm duhet të jenë pjesë e secilës thirrje publike: objektivat e thirrjes publike, kriteret për aplikim, udhëzimet për dorëzimin e aplikacionit, si dhe kriteret e vlerësimit, dokumentet e detyrueshme dhe jo të detyrueshme që do të dorëzohen, afatet kohore, informacioni mbi

⁵⁵ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

kontraktimin, informacioni mbi monitorimin dhe vlerësimin, si dhe një kalendar për zbatimin e thirrjes publike.

Brenda shtatë ditëve pasi thirrja të jetë mbyllur, rezultatet preliminare duhet të publikohen në internet, ndërsa aplikantët duhet të njoftohen me shkrim për statusin e aplikimit të tyre. Kjo listë finalizohet vetëm pasi komisioni i ankesave të ketë shqyrtuar të gjitha ankesat, në një kornizë kohore prej pesë ditëve. Neni 19 i Rregullores kërkon që të gjithë ofruesit e mbështetjes financiare publike të parandalojnë konfliktin e interesit gjatë përzgjedhjes së përfituesve, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi. Anëtarët e caktuar të komisionit të vlerësimit dhe komisionit të ankesave duhet të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se prania e tyre në komisione të tilla nuk krijon konflikt interesit. Nëse shfaqet një konflikt i interesit, anëtari/anëtarët duhet të zëvendësohen.

Shtatëdhjetë përqind⁵⁶ e OShC-ve të anketuara pohuan se kanë hasur në thirrje të hapur për ndarjen e fondeve publike të paktën një herë në vit. Raporti gjithëpërfshirës vjetor që publikohet nga ZKM/ZQM mbi mbështetjen financiare publike për OShC-të 2018⁵⁷ nuk ofron një vlerësim të qartë rreth fondeve që janë ndarë pa publikimin e thirrjeve publike. Sidoqoftë, ky raport ofron rekomandime në lidhje me disa hapa që institucionet publike mund të ndërmarrin për të rritur transparencën. Për më tepër, raporti bën dallimin ndërmjet ofruesve kryesorë të fondeve publike në të dyja nivelet e qeverisjes. Pas analizimit të ueb faqeve të tyre, rezultoni se katër nga pesë ofrues të nivelit qendror kanë publikuar thirrje të hapura në ueb faqet e tyre. Mirëpo, në nivel lokal, vetëm një nga pesë ofruesit më të mëdhenj të fondeve publikoi thirrje të hapura në internet. Në nivel qendror, vetëm Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kanë publikuar një raport vjetor për fondet publike të ndara për OShC-të. Ky raport paraqet në hollësi emrat e organizatave dhe fondet e ndara për to. Gjithashtu, paraqet në mënyrë detajore aktivitetet, projektet ose programet e mbështetura specifike. Në nivel lokal, asnjë nga pesë ofruesit më të mëdhenj të fondeve publike nuk e ka publikuar raportin e fundvitit. Të dhëna të tilla vihen në dispozicion vetëm në përmbledhjet e fundvitit, përmes raportit gjithëpërfshirës vjetor të ZKM/ZQM rreth ofrimit të mbështetjes financiare publike për organizatat e shoqërisë civile. Rreth 70%⁵⁸ të OShC-ve pajtohen ose deri diku pajtohen që format e aplikimit janë të lehta dhe se kriteret e aplikimit për fonde nuk janë të tepruara. Për gjysmën e OShC-ve të anketuara, kriteret e përzgjedhjes janë të thjeshta për t'u kuptuar dhe janë lehtë të qasshme për publikun. Shtatëdhjetë përqind e organizatave të anketuara nuk pajtohen ose deri diku nuk pajtohen që vendimet për ndarjen e fondeve janë të paanshme dhe nuk çojnë në konflikt të interesit. Gjetjet e Raportit të Auditimit Vjetor 2017⁵⁹ (publikuar në vitin 2018) nxjerrin në pak mungesën e mekanizmave të monitorimit për ndarjen e fondeve publike tek OShC-të në fushën e arsimit.

2.2.3. Llogaridhënia, monitorimi dhe vlerësimi i financimit publik

Mjedis pjesërisht i favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores është rregulluar edhe sistemi i monitorimit dhe vlerësimit të fondeve publike. Dispozitat e Rregullores parashikojnë që për secilën kontratë të fituar, ofruesi i mbështetjes financiare cakton një zyrtar apo ekip përgjegjës për të monitoruar zbatimin e projektit/programit. Monitorimi i mbështetjes financiare duhet të kryhet përmes vizitave të rregullta dhe mbikëqyrjes financiare, për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e Rregullores dhe arritjen e qëllimit për të cilin ofrohet mbështetja financiare. Nëse zyrtari/ekipi i monitorimit vëren shpërdorim të fondeve, ai ose ajo duhet ta informojë

⁵⁶ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁵⁷ <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/07/Raporti-p%C3%ABr-financim-t%C3%AB-OJQ-ve2018-ang.pdf>

⁵⁸ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁵⁹ <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2019/08/RVA-2018-Eng-2.pdf>

kryeshefin ekzekutiv ose kreun e institucionit. Masa të tjera duhet të merren në përputhje me nivelin e shkeljes së aplikuar nga përfituesi. Varësisht nga niveli i shkeljes, masat e përcaktuara me Rregullore radhiten prej anulimit të kontratës e deri tek procedurat gjyqësore. Përveç kësaj, përfituesit janë të obliguar të raportojnë në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me zbatimin e projekteve/programeve të tyre.

Tridhjetëtri organizata⁶⁰ që pohuan se kanë pranuar fonde publike, pohuan se u është kërkuar të dorëzonin një raport të detajuar të aktiviteteve dhe shpenzimeve të tyre. Shtatë OShC⁶¹ theksuan se kanë qenë subjekt i vizitave të paparalajmërueshme të monitorimit, ndërsa katër OShC deklaruan se ishin njoftuar nga autoritetet shtetërore para vizitave të tyre. Pesë organizata⁶² theksuan se nuk ishin monitoruar fare, ndërsa dy prej të anketuarve pohuan se nuk u ishte kërkuar të dorëzonin ndonjë raport mbi aktivitetet ose shpenzimet. Raporti i Qeverisë për ndarjen e fondeve publike për OShC-të sugjeron që institucionet publike do të duhej të investonin më shumë në sistemet e tyre të monitorimit dhe vlerësimit. Në mënyrë të ngjashme, raporti vjetor i auditorit për vitin 2018 nënvizon se grantet e ndara për klubet dhe federatat e sportit nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e cila është ofruesi më i madh i fondeve publike për OShC-të, nuk u monitoruan për të vërtetuar nëse është arritur qëllimi i paracaktuar. Të gjitha këto shpiejnë në një perceptim të përgjithshëm se monitorimi dhe vlerësimi nuk është duke u bërë sipas standardeve të përcaktuara nga Rregullorja për ndarjen e fondeve publike për OShC-të. Nga ana tjetër, rishikimi i ueb faqeve të ofruesve kryesorë të fondeve publike tregon se asnjë institucion nuk ka publikuar ndonjë raport të monitorimit ose vlerësimit. Qasja në dokumentet publike ka dëshmuar se madje edhe vetë institucionet publike nuk kryejnë kontrolle për të verifikuar nëse zyrtarët e monitorimit janë caktuar apo nuk janë caktuar siç parashikohet nga kërkesat ligjore.

2.2.4. Mbështetja jofinanciare

[Mjedis pjesërisht i favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.](#)

Ligji nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës u ndryshua në vitin 2019. Ky ligj ka për qëllim shfrytëzimin efektiv të pronës së paluajtshme të komunës. Ligji i ri, sikurse ligji i mëparshëm, përcakton vetëm kriteret e përgjithshme për të gjithë shfrytëzuesit, pa marrë në konsideratë karakterin e veçantë të organizatave të shoqërisë civile. Si rrjedhojë, prona e komunës mund t'u jepet në shfrytëzim personave fizikë apo juridikë përmes konkurrencës së hapur, pas propozimit nga kryetari i komunës, vendimit të Kuvendit të Komunës dhe pas vlerësimit të kryer nga komisioni për vlerësim. Nga shtatë anëtarët e komisionit, njëri prej tyre duhet të jetë ekspert nga shoqëria civile. Ndonëse procedurat mund të anashkalohej në disa raste të veçanta të përcaktuara me ligj, OShC-të nuk i përkasin kësaj kategorie. Nuk ekzistojnë dispozita të veçanta për përdorimin e njëhershëm të pronave komunale ose pronave të tjera publike nga shoqëria civile. Ndryshimet kryesore të parashikuara nga ligji i ri kanë të bëjnë me afatet kohore dhe themelimin e komisioneve për vlerësim dhe ankesa. Kriteret e përzgjedhjes së OShC-ve që janë të interesuara për shfrytëzimin e mbështetjes jofinanciare kanë mbetur të zhvillohen përmes legjislacionit sekondar. Megjithatë, drafti i aktit nënligjor parashikon që secila komunë duhet të zhvillojë kriteret e veta të përzgjedhjes. Ky propozim është tërësisht në kundërshti me kërkesat e organizatave të shoqërisë civile.

Nga ana tjetër, Rregullorja për financimin publik për OShC-të nënvizon se dispozitat e saj zbatohen në mënyrë të barabartë për mbështetjen jofinanciare publike për OShC-të. Kjo vlen për pronat publike të institucioneve qendrore dhe atyre komunale dhe për çfarëdo

⁶⁰ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁶¹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁶² Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

forme tjetër të mbështetjes jofinanciare, e cila sipas organizatës buxhetore duhet të kalojë përmes një procesi konkurrues. Format tjera të mbështetjes jofinanciare shtetërore nuk janë në dispozicion. Ekzistojnë disa OShC që ofrojnë hapësira falas për organizatat tjera, si dhe OShC-të që ofrojnë aktivitete falas për ngritjen e kapaciteteve.

Sipas anketës, gjatë vitit të kaluar, rreth 20%⁶³ e OShC-ve kanë pasur qasje ndaj mbështetjes jofinanciare shtetërore. Rreth 35%⁶⁴ e OShC-ve të anketuara pohuan se nuk kishin aplikuar asnjëherë për mbështetje jofinanciare shtetërore, ndërsa 25%⁶⁵ prej tyre nuk ishin në dijeni se ekziston një mbështetje e tillë. Pesë përqind⁶⁶ e OShC-ve kanë përfituar nga mbështetja jofinanciare përmes thirrjeve të hapura, krahasuar me 17%⁶⁷ të cilat kanë paraqitur kërkesë për qasje direkte para institucioneve shtetërore. Dymbëdhjetë⁶⁸ OShC pohuan se aplikacionet e tyre përmes thirrjeve të hapura ishin refuzuar, ndërsa pesë⁶⁹ OShC theksuan se ishin refuzuar pasi që kishin kontaktuar drejtpërdrejt me institucionet shtetërore. Në realitet, nuk ka raste kur OShC-ve u është refuzuar qasja në mbështetjen jofinanciare shtetërore për shkak të lidhjeve të tyre politike ose qëndrimit kritik. Të dhënat e siguruara përmes qasjes në informatat publike kanë nxjerr në pah se është e rrallë mbështetja jofinanciare për OShC-të nga komunat. Llojet e zakonshme të mbështetjes së ofruar jofinanciare janë hapësira publike për zhvillimin e takimeve, trajnimeve, përvjetorëve dhe shërbimeve të internetit. Vetëm shtatë komuna kanë ofruar mbështetje jofinanciare për OShC-të, teksa asnjëra prej tyre nuk ka ofruar të njëjtën gjë për bizneset. Shumicën e kohës, hapësira publike ofrohet bazuar në kërkesat e OShC-ve.

Kutia 4: Vlerësimi i udhëzuesit të BE-së për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit

Objektivi 2. Rezultati 2.4.a; 2.4.b; 2.4.c. Rregullorja për financimin publik për OJQ-të ka përcaktuar një sistem të decentralizuar të ndarjes së fondeve publike. Në realitet, rreth 70 për qind të OShC-ve pajtohen ose deri diku pajtohen që format e aplikimit janë gjithëpërmblendhëse. Shtatëdhjetë e tre për qind e OShC-ve nuk pajtohen ose deri diku nuk pajtohen që fondet publike ndahen në mënyrë të paanshme dhe nuk çojnë në konflikt të interesit. Në vitin 2018, nga buxheti i gjithëmbarshtëm i shtetit prej 1,8 miliardë €, sipas raportit të Qeverisë, 24 milion € iu janë shpërndarë OShC-ve si mbështetje financiare. Pasi KCSF analizoi listat e përfituesve, rezultoi se vetëm 9 milion € iu ishin ndarë OShC-ve. Pjesa tjetër u ishte ndarë operatorëve ekonomik, federatave, klubeve sportive dhe shërbimeve të ofruara nga OShC-të në emër të institucioneve shtetërore.

⁶³ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁶⁴ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁶⁵ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁶⁶ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁶⁷ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁶⁸ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁶⁹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

Nën-fusha 2.3. Burimet njerëzore

2.3.1. Punësimi në Organizata të Shoqërisë Civile

Mjedis pjesërisht i favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Procesi i ndryshimit të Ligjit të Punës filloi në vitin 2014 dhe vazhdon të mbetet në proces e sipër. Ligji aktual nuk përmban dispozita të veçanta për OShC-të. Si rrjedhojë, sektori i shoqërisë civile u nënshtrohet kërkesave të njëjta si sektorët tjerë. Dispozitat e pushimit të lehonisë, të cilat janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit, janë problematike për OShC-të. Për shkak të mbizotërimit të financimit në bazë të projekteve në sektorin e shoqërisë civile, vetëm disa prej OShC-ve kanë fonde të mjaftueshme për të mbuluar pjesën e tyre të pagesave për pushimin e lehonisë. Një tjetër sfidë e identifikuar nga OShC-të është mbizotërimi i kontraktimit në bazë të angazhimit në projekt për personelin e tyre. Ky model nuk përmbledh domosdoshmërisht të gjitha përfitimet potenciale të garantuara me ligj për punonjësit, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e punësimit. Projektligji ka kaluar leximin e parë në qershor të vitit 2019. Mungojnë dispozitat e veçanta për punësim nëpër OShC-të. Ndryshimet kryesore përfshijnë dispozitat që ndalojnë diskriminimin e çdo forme kundër punonjësve, duke përfshirë edhe gratë shtatzënë. Projektligji shkurtoi kohëzgjatjen e kontratave me afat të caktuar nga dhjetë në tre vjet, teksa një kontratë me afat të caktuar mund të zgjatet jo më shumë se dy herë brenda një periudhe kohore prej tre vjetëve. Këtu përjashtim përbëne kontraktimi në bazë të angazhimit në projekt. Ky përjashtim është pozitiv duke e pasë parasysh natyrën e financimit të organizatave të shoqërisë civile.

Komentet e KCSF-së në projekt – ligj sugjerojnë që të ofrohen më shumë detaje në lidhje me përjashtimet që kanë për bazë karakteristikat e financimit të shoqërisë civile. Përderisa ligji i punës është duke ndryshuar, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka inicuar një proces të veçantë për të hartuar një ligj tjetër për pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror. Shoqëria civile sugjeroi që Qeveria të mbulojë 70% të pagës së punonjësit gjatë gjashtë muajve të parë të pushimit të lehonisë. Projektligji i prezantuar aktualisht përcakton që tre muajt e parë të pushimit me pagesë të mbulohen nga punëdhënësi, i cili paguan 70% të pagës bazë, ndërsa gjashtë muajt e ardhshëm mbulohen nga Qeveria me një normë prej 50% të pagës bazë. Projektligji ofron mundësinë për ta vazhduar pushimin e lehonisë për tre muaj shtesë pa ndonjë pagesë. Për shkak se të dyja ligjet e plotësojnë njëri-tjetrin, përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë kërkuar procedimin e tyre të njëkohshëm. Prapëseprapë, pasi që ligji për pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror imponon shpenzime të mëdha financiare për Qeverinë, paraqitja e këtij ligji para kuvendit është shtyer për më vonë.

Shumica e OShC-ve theksuan se nuk posedojnë ndonjë informacion rreth programeve qeveritare për punësim (57%)⁷⁰, ndërsa shtatë përqind u përgjigjën se nuk ka programe stimuluese për punësim në OShC. Shtatë përqind⁷¹ e organizatave që kanë pasur njohuri rreth këtyre programeve konsiderojnë se ato nuk janë interesante sa duhet. Njëzet e tre përqind e OShC-ve nuk kanë përfituar nga stimulimet shtetërore për shkak se nuk kishin punësuar punonjës gjatë vitit të kaluar. Vetëm pesë organizata⁷² pohuan se kishin përfituar nga programe të tilla. Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës është organi që grumbullon informata rreth numrit të punonjësve në sektorin e shoqërisë civile, punonjësve me orar të plotë dhe atyre me orar të shkurtuar pune, si dhe kontributeve të gjithëmbarshme që paguhën nga sektori i shoqërisë civile.

70 Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

71 Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

72 Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

2.3.2. Vullnetarizmi në OShC

Mjedis pjesërisht i favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Korniza ligjore në fuqi rregullon vetëm vullnetarizmin nga të rinjtë e moshës 15-24 vjeç, sipas Ligjit nr.03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë dhe sipas Udhëzimit Administrativ nr. 01/2016 për vullnetarizmin e të rinjve. Ky i fundit përcakton procedurat për regjistrimin, verifikimin dhe certifikimin e vullnetarëve të rinj. I inicuar në gjysmën e dytë të vitit 2017, procesi i hartimit të ligjit për vullnetarizmin, në përgjithësi është akoma në fillimet e tij. Rishtazi, një grup punues që përfshinë përfaqësuesit e shoqërisë civile është duke e hartuar koncept dokumentin. Detyrat kryesore të këtij koncept dokumenti janë përcaktimi i parimeve, kushteve dhe të drejtave të vullnetarëve, themelimi i një organi mbështetës për vullnetarë dhe krijimi i mekanizmave për monitorim dhe vlerësim. Stimulimet në dispozicion për vullnetarët përfshijnë qasjen ndaj aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve dhe rimbursimin e shpenzimeve gjatë periudhës së angazhimit. Që të dyjat kanë për qëllim të shtojnë angazhimin e të rinjve në vullnetarizëm. Nga ana tjetër, zyrtarët e intervistuar të Qeverisë⁷³ listuan takimet me OShC-të dhe vullnetarët, si dhe punëtoritë mbi procedurat për të certifikuar vullnetarët, si stimulim për promovimin e vullnetarizmit. Mungesa e programeve dhe mekanizmave shtetërorë i dobëson përpjekjet ekzistuese të Qeverisë për ta promovuar vullnetarizmin. Platforma në internet për regjistrimin e vullnetarëve e ka lehtësuar procesin, ndërsa procedurat janë të lehta për t'u zbatuar. Procedurat e regjistrimit nuk e ndalojnë vullnetarizmin spontan në përgjithësi.

Në bazë të legjislacionit në fuqi, organizatat që angazhojnë vullnetarë duhet të lidhin marrëveshje me vullnetarë. Të rinjtë që angazhohen si vullnetarë duhet të zbatojnë disa kritere në lidhje me kohëzgjatjen e angazhimit, siç janë: personat nën moshën 18 vjeçare mund të angazhohen si vullnetarë jo më shumë se 26 orë në muaj. Vullnetarët ndërmjet moshës 18-24 vjeçare mund të angazhohen si vullnetarë jo më shumë se 130 orë në muaj. Vullnetarët nën moshën 16 vjeçare janë të detyruar të vërtetojnë angazhimin e tyre përmes lejes së prindërve ose kujdestarit. Përveç kësaj, Neni 3 i Udhëzimit Administrativ parashikon që para angazhimit të tyre, vullnetarët e rinj duhet të njoftohen në lidhje me të drejtat, detyrat, përfitimet dhe rreziqet përkatëse të mundshme.

Departamenti i Rinisë, i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është i vetmi organ që nxjerr të dhëna në lidhje me numrin e të rinjve të regjistruar si vullnetar, numrin e organizatave që kanë angazhuar vullnetarë dhe stimulimet që janë në dispozicion për vullnetarizmin e të rinjve. Shumica dërmuese e OShC-ve të intervistuar (86%)⁷⁴ deklaruan se nuk janë të informuara rreth ndonjë programi shtetëror, i cili promovon angazhimin e vullnetarëve. Nuk është raportuar për vështirësi në qasjen ndaj këtyre programeve në raste kur ato janë në dispozicion. Rreth 44%⁷⁵ të OShC-ve konsiderojnë se korniza ligjore është stimuluese ose deri diku stimuluese për organizimin e aktiviteteve vullnetare. Nga ana tjetër, 27%⁷⁶ e organizatave konsiderojnë se korniza ligjore nuk është fare stimuluese, ndërsa 11%⁷⁷ organizata pohuan se nuk ekziston ndonjë kornizë ligjore në lidhje me vullnetarizmin. OShC-të nuk kanë raportuar për ndonjë formë të kufizimeve sa i përket vullnetarizmit⁷⁸.

⁷³ Intervista me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, 18 qershor 2019

⁷⁴ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁷⁵ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁷⁶ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁷⁷ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁷⁸ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

2.3.3. Arsimi joformal

Mjedis pjesërisht i pafavorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Organizatave të shoqërisë civile në Kosovë u lejohet të ofrojnë veprimtari arsimore, duke përfshirë arsimin joformal, në përputhje me statutet dhe fushëveprimet e tyre. Arsimi joformal rregullohet me Udhëzimin Administrativ mbi Arsimin Joformal për të Rinjtë, i miratuar në vitin 2015 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Gjatë vitit 2019, nuk ka pasur zhvillime në lidhje me legjislacionin për mbështetjen e arsimit joformal. Autoriteti kombëtar i kualifikimeve është i autorizuar për të akredituar dhe njohur arsimin joformal. Kurrikula shtetërore përfshinë tema të kufizuara në lidhje me shoqërinë civile, të cilat kryesisht janë të arsimit fillor, përmes lëndës së edukatës qytetare. Megjithatë, përfaqësuesit e intervistuar të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit e konsiderojnë legjislacionin në fuqi si të përshtatshëm dhe të përgjegjshëm ndaj nevojave të sektorit të OShC-ve. Përfaqësuesit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës theksuan se “nuk ka nevojë të ndryshohet kurrikula, meqë konsiderohet se temat e lidhura me shoqërinë civile janë të përfshira në mënyrë të mjaftueshme”. Ajo çfarë konsiderohet më shumë si një çështje për Ministrinë është niveli i të kuptuarit dhe i të qenit i informuar rreth temës nga ana e mësimitdhënësve. Ministria nuk ka ndonjë sistem në funksion për monitorim dhe vlerësim në lidhje me këtë çështje.

Duke marrë parasysh faktin se temat e shoqërisë civile janë të rralla në kurrikulën e arsimit, ekzistojnë vetëm disa raste të memorandumëve të mirëkuptimit midis universiteteve private dhe OShC-ve për programet e punës praktike dhe atyre të vullnetarizmit. Ofrimi i arsimit joformal nuk është një veprimtari e zakonshme për organizatat e shoqërisë civile në Kosovë. Të dhënat e siguruar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve tregojnë për një prani të vogël të OShC-ve që janë certifikuar për të ofruar trajnime dhe aftësim joformal. Në vitin 2019, ishte certifikuar vetëm një OShC për të ofruar trajnime profesionale, ndërsa nga listat e siguruar specifikohet se gjatë viteve të mëparshme ishin certifikuar tri OShC të tjera. Ato kryesisht ofrojnë trajnime profesionale.

Kutia 5: Vlerësimi i udhëzimeve të BE-së për mbështetjen e BE-së ndaj shoqërisë civile në vendet në zhvillim

Objektivi 1. Rezultati 1.2.a; 1.2.c; 1.2.d; 1.2.e. Ka mungesë të statistikave zyrtare në lidhje me sektorin e shoqërisë civile në Kosovë. Disa institucione sigurojnë informacione të pjesshme mbi shoqërinë civile, që duhet të kombinohen me instrumentet e grumbullimit të të dhënave të KCSF-së, për të krijuar një paqyrë të përgjithshme përmbledhëse. Gjatë 12 muajve të fundit, 4,009 punonjës kanë paguar kontribute pensionale. Numri i punonjësve me më shumë se një profesion, një prej të cilëve është ai i sektorit të shoqërisë civile, është 9,533. Numri i vullnetarëve është 10,000.

Fusha 3: Marrëdhënia Qeveri-OShC

Nën-fusha 3.1. Korniza dhe praktikat e bashkëpunimit

3.1.1. Politikat dhe strategjitë shtetërore për zhvillimin e shoqërisë civile dhe bashkëpunimin me to

Mjedis pjesërisht i favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Strategjia e re qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019 - 2023⁷⁹ hyri në fuqi në shkurt të vitit 2019. Objektivat dhe kornizat e saj të përgjithshme trajtojnë mungesën e mekanizmave dhe sfidave të identifikuara gjatë zbatimit të strategjisë së mëparshme.

Të gjitha objektivat strategjike dhe aktivitetet e strategjisë së re mbështeten në rezultatet e strategjisë së mëparshme. Megjithatë është zbatuar shumë pak, kjo strategji paraqet një bazë mjaft solide për zhvillimin e mëtejshëm të saj nga ana e Qeverisë, shoqërisë civile dhe palëve tjera të interesit. Objektivat e strategjisë së re përfshijnë ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve publikë dhe avancimin e mekanizmave të zbatimit të Rregullores për Standardet minimale për procesin e konsultimit publik dhe Rregullores për financimin publik të OShC-ve. Kjo gjithashtu synon të përmirësojë sistemin e ofrimit të shërbimeve publike nga OShC-të dhe rritjen e vullnetarizmit në programet me interes publik. Qeveria ka zotuar një buxhet prej 235,500 € për zbatimin e Strategjisë dhe planit të saj të veprimit, që përmbledh treguesit, objektivat, rezultatet e synuara dhe kornizën kohore. Përveç kësaj, strategjia parashikon angazhimin e dy anëtarëve specifikë të personelit që do të punojnë vetëm për qëllimet e zbatimit të saj.

Qeveria nuk siguroi as buxhet dhe as burime njerëzore për të cilat ishte zotuar për strategjinë 2013-2017. Ministria e Financave u zotua për një buxhet prej 137.960 € për të favorizuar zbatimin e strategjisë. Megjithatë, përveç takimeve të zhvilluara në hapësirat e Qeverisë, të cilat u mbuluan nga buxheti i Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM), të gjitha aktivitetet e tjera u mundësuan përmes mbështetjes së donatorëve.

KCSF dhe disa përfaqësues të shoqërisë civile ishin pjesë e grupit punues, të cilët hartuan që nga fillimi strategjinë aktuale për bashkëpunim, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm. Përveç kësaj, këta përfaqësues kërkuan një përfshirje dhe angazhim më të madh të organizatave të shoqërisë civile në proces të hartimit. Për më tepër, Platforma Civikos, një rrjet i OShC-ve, zhvilloi takime gjithëpërfshirëse konsultative me OShC-të për hartimin e Strategjisë së re gjatë vitit 2018.

Në vitin 2019 u themelua këshilli i ri, që është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të strategjisë. Ky këshill përbëhet prej 29 anëtarëve, 15 prej të cilëve janë përfaqësues të shoqërisë civile, të përzgjedhur nga vetë OShC-të përmes një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues. Pjesa tjetër janë nëpunës civilë. Anëtarët e këshillit janë pjesë e grupeve punuese të cilët fokusohen në secilin prej katër objektiveve strategjike. Rregullat e procedurës së këshillit garantojnë marrjen në konsideratë të të gjitha iniciativave që rrjedhin

⁷⁹ <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/08/Strategjia-ne-tri-gjuhe.pdf>

prej OShC-ve, ndërsa e njëjta gjë vlen edhe për grupet punuese.

Shumica e organizatave të shoqërisë civile nuk morën pjesë në procesin e hartimit të strategjisë qeveritare për bashkëpunim. Vetëm rreth 23%⁸⁰ e organizatave deklaruan se kanë marrë pjesë në procesin e hartimit, ndërsa 53%⁸¹ e tyre nuk kanë qenë të përfshirë në këtë proces. Për më tepër, OShC-të nuk janë të informuara për ekzistencën e kësaj strategjie. Njëzet e dy përqind⁸²deklaruan se nuk kanë asnjë informacion për ekzistencën e ndonjë dokumenti për bashkëpunimin midis qeverisë dhe sektorit, ndërsa dy organizata theksuan se nuk kanë qenë në dijeni për ndonjë dokument që përcakton parimet e bashkëpunimit midis organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve qendrore.

Raporti i vlerësimit të strategjisë së mëparshme për bashkëpunim, i hartuar nga ZQM/ZKM, nënvizon se janë zbatuar 78% të aktiviteteve të parashikuara në strategji. Nga ana tjetër, OShC-të e kundërshtojnë këtë shifër sepse metodologjia e aplikuar nuk është e orientuar drejt rezultateve. Objektivat e saj u realizuan shumë pak, me rezultatet aktuale të dëshmuara vetëm në fund të periudhës së zbatimit, pasi hyri në fuqi Rregullorja për Standardet minimale për procesin e konsultimit publik dhe Rregullorja për procedurat dhe kriteret për financimin publik të OShC-ve. Hartimi i të dyja rregulloreve u bazua në kontributet e shoqërisë, qoftë përmes konsultimeve publike ose takimeve dypalëshe me zyrtarët publikë. Objektivi i caktuar për ofrimin e shërbimeve publike nga OShC-të dhe vullnetarizmin nuk ka bërë ndonjë përparim. Vlerësimi përfundimtar i strategjisë së mëparshme për bashkëpunimin OShC-Qeveri ishte realizuar vetëm pas përfundimit të periudhës së zbatimit të saj. Sa i përket strategjisë aktuale, ekziston një angazhim për vlerësimi afatmesëm. Në Kosovë, përveç të dhënave në lidhje me disa çështje specifike, sektori i shoqërisë civile nuk është pjesë e statistikave zyrtare të përpunuara nga institucionet publike. Megjithatë, grupet punuese të secilit objektivi të strategjive përfshijnë organizatat me përvojë në fushën përkatëse për të siguruar që nevojat e OShC-ve të trajtohen siç duhet.




Figura 5 Përfshirja e OShC-ve në zbatimin e strategjisë

3.1.2. Institucionet dhe mekanizmat për zhvillimin e shoqërisë civile dhe bashkëpunimin me to

Mjedis i favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Këshilli për zbatimin e strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile është organi i përbashkët i autorizuar për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të aktiviteteve të strategjisë. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZQM/ZKM), që është Sekretariati i Këshillit, gjithashtu shërben si njësi kryesore e Qeverisë për bashkëpunimin me shoqërinë civile. Sa i përket mekanizmave tjerë që janë në funksion, në

⁸⁰ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁸¹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁸² Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

kuadër të Kuvendit të Kosovës më parë ka qenë Zyra për koordinim me donatorët dhe marrëdhëniet me shoqërinë civile. Megjithatë, intervista e zhvilluar rishtazi me zyrtarët e Kuvendit të Kosovës nxorri në pah se zyra është bërë pjesë e Departamentit për Media dhe Komunikim Masiv. Deklarata e partneritetit me shoqërinë civile është referuar si mekanizmi i vetëm funksional për bashkëpunimin me OShC-të. Aktivitetet në të cilat shoqëria civile konsiderohet si kontribuesi kryesor përfshijnë: menaxhimin dhe organizimin e ngjarjeve promovuese. Të gjitha këto tregojnë për përfshirjen dhe bashkëpunimin e dobët të OShC-ve me Kuvendin e Kosovës.

Këshilli për zbatimin e strategjisë përbëhet prej 29 anëtarëve, 15 prej të cilëve janë përfaqësues të shoqërisë civile dhe 14 janë zyrtarë publikë. Ky është një numër i zakonshëm i anëtarëve që nga themelimi i këshillit. Anëtarët janë pjesë e grupeve punuese që organizohen rreth katër objektivave strategjikë. Rregullat e procedurës së këshillit dhe grupeve të tij punuese garantojnë marrjen në konsideratë të të gjitha iniciativave që rrjedhin prej OShC-ve. Kur u pyetën për shpeshësinë e komunikimit me institucionet publike përkatëse, 48%⁸³ e të anketuarve iu referuan Departamentit për Regjistrimin e OShC-ve në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë kontaktohet nga 31 përqind⁸⁴ e organizatave, ndërsa 24 përqind⁸⁵ e të intervistuarve pohuan të kenë komunikuar me Zyrën e Kuvendit për Koordinim me Donatorët dhe Komunikim me Shoqërinë Civile. Ka një rritje të lehtë të ndarjeve buxhetore për strategjinë aktuale në krahasim me atë të mëparshmen. Të dhënat e siguruara nga ZQM/ZKM tregojnë se 235,500 € ishin buxhetuar për të lehtësuar zbatimin e strategjisë, ndërsa për vitin e parë të implementimit buxheti i planifikuar ishte rreth 60,000 €.

Kutia 6: Vlerësimi i udhëzuesit të BE-së për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit

Objektivi 3. Rezultati 3.1.b Ekzistojnë disa mekanizma që fasilitojnë bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë dhe sektorit të SHC-së. Strategjia e re 2019-2023 për bashkëpunimin Qeveri-OSHC hyri në fuqi në shkurt të vitit 2019. Kjo strategji mbështetet në sfidat dhe mangësitë e identifikuara gjatë zbatimit të strategjisë së mëparshme. ZQM/ZKM është Sekretariati i Këshillit për zbatimin e strategjisë së bashkëpunimit. Kjo zyrë gjithashtu shërben si njësi kryesore e Qeverisë për bashkëpunimin me shoqërinë civile. Kuvendi i Kosovës ka shkrirë Zyrën për koordinim me donatorë dhe marrëdhënie me shoqërinë civile në një departament tjetër.

⁸³ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁸⁴ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁸⁵ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

Nën-fusha 3.2. Përfshirja në procesin e politikbërjes dhe vendimmarrjes

3.2.1. Standardet për përfshirjen e OShC-ve

Mjedis pjesërisht i favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Hyrja në fuqi e Rregullores nr. 05/2016 për Standardet minimale për procesin e konsultimit publik në janar të vitit 2017, shënon një hap të rëndësishëm në aspektin e përfshirjes së OShC-ve dhe mbarë qytetarëve në proceset e vendimmarrjes. Në të kaluarën, konsultimet publike nuk respektonin disa standarde ose procedura sistematike, ndërsa tani zbatohen kërkesat specifike dhe afatet kohore. Rregullorja përcakton që pjesëmarrja e OShC-ve dhe mbarë qytetarëve të jetë e detyrueshme për institucionet e nivelit qendror, përveç Kuvendit. Qeveria është e detyruar t'i zhvillojë proceset pjesëmarrëse të vendimmarrjes duke filluar nga hartimi i agjendës së legjislacionit. Një mekanizëm që ka derivuar nga Rregullorja është platforma në internet për konsultimin publik me shkrim, e lansuar në shkurt të vitit 2017. Një afat i zakonshëm kohor për dërgimin e komenteve me shkrim është 15 ditë pune, teksa për akte më të ndërlikuara Rregullorja lejon zgjatjen e këtij afati kohor deri në 60 ditë. Organi propozues është i detyruar ta publikojë në faqen e tyre të internetit raportin final të konsultimit publik, i cili përmban komentet e dërguara nga qytetarët dhe përgjigjet në to nga ana e institucioneve publike. Nëse konsultimet publike nuk organizohen si duhet, Rregullorja kërkon kthimin e procesit në fazën kur vendimmarrja gjithëpërfshirëse është e detyrueshme.

Gjatë viteve të mëparshme, organizatat e shoqërisë civile avokuan për dispozita të ngjashme ligjore edhe në nivelin komunal. Si rezultat, në dhjetor të vitit 2018, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal miratoi Udhëzimin Administrativ nr. 04/2018 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik në Komuna. Iniciativa në vetvete është një shenjë pozitive. Sidoqoftë, dispozitatave ligjore të këtij udhëzimi administrativ u mungojnë shumë hapa që janë të nevojshëm për zbatimin efektiv, siç është mungesa e standardeve specifike, afateve kohore ose mekanizmave të zbatimit. Rregullorja e Punës së Kuvendit, për të cilën ishte nevojitur shumë kohë për t'u hartuar, është ende në proces të ndryshimit. Në këtë aspekt, organizatat e shoqërisë civile janë duke avokuar për t'i adresuar dispozitatat jodetyruese të përfshirjes së OShC-ve në politikbërje. Ministria e Integritimit Evropian ka publikuar Udhëzimet për përfshirjen e shoqërisë civile në strukturat e MSA-së në shkurt të vitit 2018. Organizatat e shoqërisë civile ishin pjesë e procesit të hartimit të dokumentit. Sidoqoftë, Ministria nuk i njoftoi OShC-të në mënyrë aktive për nivelin e zbatimit të Udhëzuesit.

Që nga viti 2017, Qeveria ka filluar trajnimin e zyrtarëve të saj për zbatimin e Standardeve minimale për procesin e konsultimit publik. Instituti i Kosovës për Administratë Publike është organi i autorizuar për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve civilë. Deri në fund të vitit 2019, të dhënat e siguruar nga Zyra e




Figura 6 Ftesa e OShC-ve për konsultim publik

Qeverisjes së Mirë/ Zyra e Kryeministrit tregojnë se në bashkëpunim me IKAP, u trajnuan 56 zyrtarë publikë. Tridhjetë nëpunës civilë të qeverisë lokale përfituan nga i njëjti trajnim. Seminaret përmbledhën tërë ciklin e përfshirjes së shoqërisë civile, duke filluar nga caktimi i agjendës dhe angazhimi i ekspertëve e deri tek konsultimet e përgjithshme publike, me kërkesa specifike për secilin hap. Caktimi i zyrtarëve përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik filloi brenda 30 ditëve pasi Rregullorja hyri në fuqi. Të dhënat zyrtare nga ministritë përkatëse paraqesin praninë e zyrtarëve të tillë në secilën prej tyre. Përgjegjësitë e tyre përfshijnë koordinimin e procesit të konsultimit publik përmes ofrimit të informatave rreth përpilimit të raporteve afatmesme dhe atyre vjetore nga zyra e ZKM/ZQM. Në veçanti, ata grumbullojnë informata rreth numrit të komenteve të pranuar, shifrave të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe të pjesëtarëve të OShC-ve në konsultimin publik dhe informata rreth komenteve të pranuar. Siç përcaktohet me Rregullore, komentet e refuzuara duhet të mbështeten me argumente.

Sipas raportit vjetor⁸⁶ të ZKM/ZQM mbi konsultimet publike të nivelit qendror të qeverisjes, në vitin 2018, nga gjithsej 245 dokumente të miratuara të politikave, 221 prej tyre e përfunduan procesin e konsultimit me shkrim përmes platformës në internet. Megjithatë, është e paqartë nëse dokumentet që janë konsultuar u janë nënshtruar elementeve të detyrueshme që e bëjnë procesin e konsultimit publik me shkrim të kompletuar dhe efektiv. Për më tepër, raporti nuk ofron ndonjë informacion nëse janë aplikuar metoda të tjera përveç konsultimeve me shkrim, për të siguruar një përfshirje më të gjerë të OShC-ve dhe qytetarëve. Raporti i monitorimit të KCSF-së për procesin e konsultimit publik nënvizon se vetëm në gjysmën e rasteve të monitoruara (50%) institucionet qeveritare vendosën të aplikojnë metoda përveç Platformës në Internet, për të rritur kontributin publik.

Shtatëdhjetë e katër përqind⁸⁷ e organizatave të shoqërisë civile raportuan se gjatë vitit të kaluar nuk ishin përfshirë në procesin e hartimit të politikave/legjisllacionit, as përmes ftesës nga ndonjë institucion publik e as nuk kishin inicuar që të merrnin pjesë në mënyrë vetanake. Anketa nxjerr në pah se institucionet publike kanë ngurruar që të përfshijnë OShC-të në proceset e vendimmarrjes. Gjysma e organizatave të intervistuar⁸⁸ theksuan se nuk ishin ftuar asnjëherë që të merrnin pjesë në konsultimet publike. Vetëm 12%⁸⁹ e OShC-ve të anketuara pohuan se ishin ftuar rregullisht të merrnin pjesë në konsultime

publike, ndërsa 40%⁹⁰ theksuan se ishin ftuar herë pas here ose vetëm ndonjëherë. Prej të ftuarve që të merrnin pjesë në proceset e vendimmarrjes, 60% e organizatave theksuan se kishin pranuar ftesa gjatë fazave të hershme të procesit të konsultimit, ndërsa vetëm 12 OShC pohuan se kishin siguruar informacion të mjaftueshëm




Figura 7 Përqindja e pranimit të komenteve të dërguara nga OShC-të

⁸⁶ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019
⁸⁷ <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-5d1f2441afb2a.pdf>
⁸⁸ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019
⁸⁹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019
⁹⁰ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

në lidhje me përmbajtjen e draft-politikave. Tetë përqind e OShC-ve theksuan se u ishte ofruar kohë e mjaftueshme (15-20 ditë siç përcaktohet me ligj) për të dhënë komente.⁹¹

Rreth 25%⁹² e OShC-ve të intervistuar pohuan se kishin në dispozicion informata të mjaftueshme në lidhje me përmbajtjen e draft dokumentit. Nga ana tjetër, të dhënat e KCSF-së nga monitorimi i zbatimit të standardeve për proceset e konsultimit publik, vëjnë në dukje se dokumenti i konsultimit ishte publikuar me kohë në 83% të rasteve. Vetëm 60% e këtyre dokumenteve të konsultimit përmbledhnin të gjitha pjesët e nevojshme, siç përcaktohet me Rregullore: përshkrimi i përmbledhur i përmbajtjes së dokumentit, përshkrimi i shkurtër i problemit të cilin e trajtojnë politikat, qëllimi i procesit të konsultimit dhe një listë ku renditen çështjet kryesore që trajton dokumenti. Tetëdhjetë përqind⁹³ e organizatave deklaruan se institucionet qeveritare të nivelit lokal publikojnë me kohë projekt-politikat dhe projektligjet. Institucionet qeveritare të nivelit qendror regjistruan një përqindje më të ulët, me rreth 66%⁹⁴ të organizatave që theksuan se projekt-politikat dhe rregulloret publikohen me kohë. Vetëm 44% e të anketuarve pohuan se Kuvendi i Kosovës ishte vlerësuar të ketë publikuar projekt-politikat dhe projektligjet me kohë.⁹⁵

Rezultatet e monitorimit të KCSF-së vëjnë në dukje se raportet përfundimtare të konsultimit publik rrallë publikohen me kohë. Këto raporte, të cilat janë të paracaktuara të përpilohen dhe publikohen në fund të secilit proces të konsultimit publik, janë publikuar në kohë në vetëm 37% të rasteve të monitoruara. Gjithashtu, shumica dërrmuese (90 përqind) e raporteve përfundimtare të konsultimit publik që janë publikuar, kanë lënë jashtë një ose më shumë pjesë, siç janë: lista e akterëve të konsultuar, metodat e aplikimit të konsultimeve, numri i kontributeve të pranuar, numri i kontributeve që janë pranuar ose refuzuar, arsyet për refuzimin e komenteve dhe vlerësimi i përgjithshëm i procesit. Rreth 13%⁹⁶ e OShC-ve që morën pjesë në konsultimet publike raportuan se komentet e tyre ishin pranuar plotësisht, ndërsa 71%⁹⁷ deklaruan se komentet e tyre ishin marrë pjesërisht në konsideratë. Organizatat e shoqërisë civile, komentet e të cilave u refuzuan, pranuan informata kthyesë me shkrim në vetëm 17%⁹⁸ të rasteve. Megjithatë deri në vitin 2018, për zbatimin e rregullores për konsultim publik u trajnuan 157 zyrtarë publikë, sipas ZQM/ZKM, kapacitetet e tyre u vlerësuan si të kënaqshme nga vetëm 8%⁹⁹ të organizatave.

3.2.2. Qasja publike në projekt-politika dhe legjislacion

Mjedis pjesërisht i favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

E drejta për qasje në informacionin publik është e drejtë kushtetuese, e cila garantohet sipas Nenit 41. Ligji për Qasje në Dokumente Publike, që ishte në një proces të gjatë të ndryshimit që nga viti 2017, u finalizua në vitin 2019. Ligji i ri favorizoi edhe më tej format dhe procedurat e qasjes në dokumentet publike, ndërsa kërkon nga secili institucion të publikojë listat e dokumenteve në dispozicion. Nga secili institucion kërkohet përditësimi i arkivave të tyre dhe publikimi në mënyrë aktive i dokumente të reja. Sidoqoftë, ligji aktual nuk kërkon publikimin e projekt-dokumente të cilët janë në procedurë e sipër. Procedurat dhe mekanizmat për qasje në publikimin e dokumenteve/informatave mbeten të qarta, si dhe sanksionet monetare për nëpunësit civilë dhe institucionet që shkelin kërkesat ligjore për qasje në publikimin e informatave. Udhëzimi Administrativ për ueb faqet e institucioneve publike, i miratuar në maj të vitit 2015, detyron publikimin e planeve vjetore

⁹¹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁹² Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁹³ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁹⁴ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁹⁵ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁹⁶ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁹⁷ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁹⁸ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

⁹⁹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

të punës dhe të projekt akteve normative për qëllime të konsultimeve publike. Në fund të vitit 2018, Qeveria lansoi portalin e të dhënave të hapura. Zyrtarët publikë janë caktuar dhe trajnuar, ndërsa platforma konsiderohet si një hap përpara në rritjen e qasjes së OShC-ve dhe qytetarëve ndaj të dhënave zyrtare. Institucionet publike duhet të japin përgjigje ndaj një kërkesë për qasje në informata/dokumente publike brenda shtatë ditëve. Kërkesat e refuzuara duhet të shoqërohen me argumentim të detajuar. Nëse informacioni/dokumenti i kërkuar përfshinë informacione që mund ta vëjnë në rrezik jetën ose lirinë personale, duhet të jepet një përgjigje brenda 48 orëve. Në rastet kur informacioni/dokumentet e kërkuara duhet të grumbullohen prej më shumë se një burimi, atëherë institucioni ka të drejtë të ketë 15 ditë shtesë për të dhënë një përgjigje. Kur një institucion publik nuk ka informacion por njohuri në lidhje me institucionin përkatës që i posedon ato, përfaqësuesi duhet ta informojë aplikantin brenda pesë ditëve prej ditës së pranimit të kërkesës. Nëse ky institucion publik nuk ka informacion ose njohuri në lidhje me institucionin përkatës, ligji parashikon një afat kohor prej shtatë ditëve për të informuar kërkuesin. Argumentet për refuzimin e qasjes në dokumentet publike kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare, informatat private dhe personale, informatat konfidenciale tregtare etj. Agjencia për Informim dhe Privatësi posedon fuqinë ekzekutive për të vënë gjoba në rast të shkeljes së të drejtës për kërkesa të përcaktuara me ligj. Gjjobat në të holla sillen prej 3,000 - 10,000 € nëse një kërkesë është refuzuar për arsye të tjera, ndryshe nga ato që parashikohen me ligj. Institucionet publike që nuk ofrojnë fare përgjigje mund të gjobiten prej 1,000 - 3,000 €. Platforma në internet për konsultimin publik, e lansuar në shkurt të vitit 2018, mundëson pjesëmarrjen e OShC-ve dhe publikut të gjerë. Njësitë qeveritare mund t'i publikojnë projekt planet vjetore, dokumentet strategjike, politikat publike, ligjet dhe legjislacionit tjetër sekondar. Të gjitha dokumentet e lartpërmendura duhet t'i nënshtrohen konsultimit me OShC-të dhe publikun e gjerë duke filluar nga fazat e hershme të zhvillimit. Përveç kësaj, Kuvendi i Kosovës ka lansuar Sistemin elektronik për monitorimin e legjislacionit, i cili mundëson qasjen në informacion dhe dokumente gjatë secilës fazë të procesit të hartimit të politikave. Gazeta zyrtare u ofron OShC-ve dhe qytetarëve mundësinë e qasjes falas në legjislacionin e miratuar. Monitorimi i




Figure 8 Qasja e OShC-ve në informata publike

KCSF-së nxjerr në pah një mospërputhje të madhe në mes të projekt propozimeve të publikuara në Platformën në internet dhe ueb faqeve zyrtare të institucioneve përkatëse. Megjithëse këto institucione janë të detyruara t'i publikojnë në ueb faqet e tyre projekt propozimet që do t'iu nënshtrohet këshillimeve, kjo ka ndodhur vetëm në 13%¹⁰⁰ të projekt propozimeve të monitoruara, në krahasim me 97%¹⁰¹, të cilat janë publikuar në Platformën në internet. Gjatë vitit të kaluar, tridhjetë e tre OShC¹⁰² të anketuara kanë kërkuar qasje në informata/dokumente publike. Nga totali i organizatave joqeveritare të anketyara, vetëm 12 prej tyre siguruan informacion/dokumente brenda afateve të përcaktuara ligjore, ndërsa 16¹⁰³ prej tyre

¹⁰⁰ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹⁰¹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹⁰² Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹⁰³ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

siguruan informacion pas afatit të përcaktuar kohor. Pesë OSHC¹⁰⁴ nuk morën përgjigje ndaj kërkesave të tyre për të siguruar qasje në informata/dokumente publike.

Kërkesat për qasje në informacionin publik u shfrytëzuan për qëllimet e këtij raporti. Një krahasim midis institucioneve të nivelit qendror dhe atyre lokal të qeverisjes tregon se në të dyja nivelet informacioni publik nuk sigurohet brenda afatit kohor të kornizës ligjore. Dy nga gjashtë institucionet publike të nivelit qendror informacionin e ofruan në kohë, ndërkohë vetëm Zyra e Kryeministrit nxori një vendim përmes të cilit lejohet qasja në informacionin/dokumentet publike. Vetëm një e treta e komunave u përgjigjën brenda afatit të caktuar kohor, teksa vetëm njëra prej tyre nxori vendimin përmes të cilit lejohet qasja në informacionin publik. Megjithatë, kërkesat për qasje në informacionin publik u shoqëruan me kufizimet e lëvizjes, si pasojë e pandemisë së COVID-19, e cila mund të jetë shkak i përgjigjeve të vonuara.

Sipas raportit vjetor të Qeverisë¹⁰⁵, shoqëria civile përbën 46% të kërkesave për qasje në informacionin publik në institucionet e nivelit lokal. BIRN, Instituti GAP dhe Lëvizja FOL janë tre organizata joqeveritare që kanë ngritur padi për shkak se nuk kanë siguruar qasje në informacionin/dokumentet publike. Të trija organizatat i kanë fituar çështjet e tyre, mirëpo vendimet gjyqësore deri më tani nuk janë zbatuar.

3.2.3. Përfaqësimi i OShC-ve në organet ndër-sektoriale

Krijimi në mënyrë të pjesërishme i mjedisit të favorshëm është kategoria e caktuar që përshkruhet nga gjetjet e këtij standardi.

Në vitin 2019, nuk është bërë ndonjë ndryshim në legjislacionin për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në organet vendimmarrëse dhe/ose atyre këshillimore, të themeluara nga institucionet publike. Legjislacioni i nivelit qeveritar lejon por nuk e detyron qeverinë të ftojë përfaqësuesit e OShC-ve për të marrë pjesë në këto organe. Si përjashtim, komisionet sektoriale të konsultimeve në nivel komunal do të duhej të themeloheshin dhe përbëheshin prej qytetarëve dhe shoqërisë civile, mirëpo vetëm një numër i vogël i komunave e kanë përmbytur këtë obligim. Një numër i organeve të pavarura ose këshillimore kanë rregulla të veçanta procedurale, të cilat parashikojnë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile, përfshirë procedurat e përzgjedhjes. Përveç këtyre organeve, nuk ekzistojnë udhëzime apo standarde për mekanizmat e përzgjedhjes të cilat do të siguronin pjesëmarrjen e duhur të shoqërisë civile.

Rezultatet e anketës tregojnë se shumica dërrmuese e OShC-ve në Kosovë nuk janë pjesë e organeve konsultative. Rreth 70%¹⁰⁶ e të anketuarve theksuan të mos kenë marrë pjesë në ndonjë organ konsultativ në institucionet e nivelit qendror. Në nivelin komunal morën pjesë rreth 20%¹⁰⁷ të OShC-ve. Për të marrë pjesë në organet konsultative, në nivelin qendror të qeverisjes, 9%¹⁰⁸ e OShC-ve u përzgjedhën përmes thirrjes së hapur, ndërsa 8%¹⁰⁹ u ftuan drejtpërdrejt nga institucionet publike. Në nivelin komunal, 16%¹¹⁰ e OShC-ve aplikuan përmes thirrjes së hapur, gjithashtu përqindje e njëjtë e OShC-ve ishin ftuar të merrnin pjesë nga ndonjë institucion publik. Në nivel të Kuvendit, 90%¹¹¹ e OShC-ve nuk ishin pjesë e ndonjë organi konsultativ. Ata që morën pjesë, raportuan të kenë aplikuar

¹⁰⁴ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹⁰⁵ <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/04/RAPORT-GJITH%C3%8BP%C3%8BRFSHIR%C3%8BS-14-03-2019-2.....pdf>

¹⁰⁶ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹⁰⁷ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹⁰⁸ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹⁰⁹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹¹⁰ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹¹¹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

përmes thirrjes së hapur (4 përqind)¹¹², ndërsa 19%¹¹³ ishin ftuar për të marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë. OShC-të nuk raportuan të ishin përballur me vështirësi në lidhje me shprehjen e mendimeve të tyre ose pjesëmarrjen në politikbërje, për shkak të pjesëmarrjes së tyre në organet ndër-sektoriale.

Kutia 7: Vlerësimi i udhëzuesit të BE-së për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit

Objektivi 3. Rezultati 3.1.a. Sipas raportit të Qeverisë për konsultim publik, në vitin 2018, nga gjithsej 245 dokumente të miratuara të politikave, 221 prej tyre iu nënshtruan procesit të konsultimit me shkrim. Megjithatë, raporti nuk ofron ndonjë informacion nëse janë marrë në konsideratë të gjitha elementet e detyrueshme që e bëjnë të efektshëm procesin e konsultimit publik me shkrim. Shtatëdhjetë e katër përqind e OShC-ve raportuan se nuk ishin përfshirë në procesin e hartimit të politikave/legjislationit. 60 përqind e atyre që morën pjesë theksuan se ishin ftuar në fazën e hershme të konsultimit, ndërsa tetë përqind të OShC-ve pohuan se u ishte ofruar kohë e mjaftueshme për të dhënë komente.

Nën-fusha 3.3. Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve

3.3.1. Angazhimi i OShC-ve në ofrimin e shërbimeve sociale dhe konkurrenca për kontratat shtetërore

Mjedis i favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Korniza ligjore për ofrimin e shërbimit publik është në proces të ndryshimit. Koncepti dokumenti i Ligjit për Familjen dhe Shërbimet Sociale u miratua në tremujorin e parë të vitit 2019. Objektivat e këtij ligji përfshijnë përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e transparencës së shërbimeve sociale, si dhe krijimin e një sistemi të qëndrueshëm financiar. Për më tepër, ky ligj përmes dispozitave të veçanta merr në konsideratë karakterin e sektorit të shoqërisë civile dhe gjithashtu miraton ofrimin e shërbimeve sociale në fusha të caktuara. Për t'i trajtuar veçoritë e ofrimit të shërbimeve në fushat e arsimit dhe shëndetësisë, ministrinë përkatëse kanë miratuar aktet e tyre nënligjore. Kërkesat ligjore janë të barabarta për OShC-të dhe subjektet tjera juridike, ndërsa nuk ekzistojnë kërkesa shtesë për angazhimin e OShC-ve në ofrimin e shërbimeve publike. Rregullorja nr. 02/2015 për kriteret dhe procedurat e mbështetjes financiare për subvencione dhe grante përcakton fushat në kuadër të shërbimeve sociale ku mund të angazhohen OShC-të. Për më tepër, Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë përcakton llojet e shërbimeve që mund të ofrohen në kuadër të fushës së arsimit. Asnjë prej tyre nuk përmban dispozita që nxisin futjen në përdorim të shërbimeve ose praktikave të reja për ofrimin e shërbimeve. Aktet nënligjore të përmendura më lartë përcaktojnë kriteret që i plotësojnë kushtet për ofrimin e shërbimeve sociale dhe arsimore nga OShC-të. Për të ofruar shërbime sociale, OShC-të duhet të pajisen me licenca në bazë të standardeve të përcaktuara. Licencat janë një parakusht për aplikim në ofrimin e shërbimeve, e kjo vlen edhe për ofruesit tjerë të shërbimeve, përveç ofruesve të shërbimeve shtetërore. Ofrimi i shërbimeve arsimore nuk i nënshtrohet licencimit, ndërsa komisioni për vlerësim i themeluar nga Ministria bën përzgjedhjen e ofruesve të shërbimeve të OShC-ve. Përveç OShC-ve, e njëjta gjë vlen edhe

¹¹² Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹¹³ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

për ofruesit tjerë të shërbimeve.

OShC-të në Kosovë zakonisht ofrojnë shërbime në fushën e kujdesit social, të arsimit dhe shëndetësisë. Të dhënat e anketës tregojnë se një numër i vogël i OShC-ve kanë aplikuar që të fitojnë një kontratë për ofrimin e shërbimeve publike. Vetëm 3 prej 16 OShC-ve¹¹⁴ që kanë aplikuar janë përzgjedhur për të ofruar shërbime publike. Të dhënat e siguruar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale tregojnë për një shifër pak më të lartë të angazhimit të OShC-ve në ofrimin e shërbimeve sociale. Sipas këtyre të dhënave, në vitin 2019, 26 OShC¹¹⁵ kanë fituar kontratë për ofrimin e shërbimeve. OShC-ve që ofrojnë shërbime sociale u kërkohet të aplikojnë për licenca, në përputhje me kodin e standardeve të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Kjo e fundit deklaroi se në vitin 2019, 12 OShC u pajisën me licencë, ndërsa ekzistojnë gjithsej 44 organizata të licencuara për të ofruar shërbime sociale. Pesë prej organizatave që theksuan se vitin e kaluar kishin aplikuar për kontrata shtetërore, i vlerësuan procedurat e licencimit si të ndërlikuar. Përfshirja e OShC-ve në tërë ciklin e zhvillimit të shërbimeve mbetet ende mbrapa, për shkak se numri i OShC-ve të përfshira është shumë i vogël.

3.3.2. Financimi shtetëror për shërbimet e ofruara nga OShC-të

Mjedis i kufizuar për operim është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi

Një problem i vazhdueshëm është mungesa e linjave të veçanta buxhetore, që planifikohen për financimin e shërbimeve të ofruara nga OShC-të. Vetëm Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Udhëzimi Administrativ për ndarjen e fondeve buxhetore nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, parashikojnë ndarjen e buxhetit për ofrimin e shërbimeve nga OShC-të dhe ofruesit tjerë të shërbimeve. Financimi sigurohet vetëm duke u bazuar në thirrjet publike për shërbimet që nuk ofrohen nga autoritetet shtetërore, zakonisht për një periudhë kohore prej katër deri në dymbëdhjetë muaj. Në vitin 2009, për shkak të problemeve me planifikim buxhetor, financimi i shërbimeve sociale ishte decentralizuar, duke e zhvendosur financimin nga niveli qendror tek ai komunal. Ky veprim nuk rezultoi i suksesshëm në krijimin e një qëndrueshmërie financiare. Si rrjedhojë, projektligji i ri për financat e pushtetit lokal parashikon krijimin e një granti të veçantë për ofruesit e shërbimeve sociale. Detajet e këtij projektligji mbeten të papërcaktuara, ndërsa hartimi i dokumentit është në procedurë e sipër.

Ndryshimi i Ligjit për Prokurimin Publik në vitin 2015 ka mundësuar më tepër harmonizimin me karakteristikat e sektorit të shoqërisë civile. Ligji i ri, përmes prokurimit publik shfuqizoi pengesat ligjore ndaj OShC-ve që pranojnë fonde publike për ofrimin e shërbimeve. OShC-të konsiderohen si operatorë ekonomikë, teksa u shfuqizua kërkesa për regjistrimin e OShC-si operatorë ekonomik. Megjithatë, çdo mbështetje financiare mund të ndahet vetëm në baza vjetore, kurse marrëveshjet afatgjata nuk mbështeten.

Në vitin 2019, ndarja e buxhetit për kontraktimin e shërbimeve sociale dhe ofrimin e trajnimeve nga OShC-të është 510,000 €. Pesë organizata të anketuara¹¹⁶ theksuan se u ishte ndaluar të aplikojnë për ofrimin e shërbimit publik, pa ofruar shpjegime specifike. Shtatëdhjetë përqind¹¹⁷ e OShC-ve që pranuan fonde nga kontratat shtetërore pohojnë se ato nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar kostot minimale të një shërbimi.

Financimi i shërbimeve sociale është posaçërisht i pamjaftueshëm për shkak të planifikimit

¹¹⁴ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹¹⁵ Kërkesa për qasje në informata publike të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, 14 maj 2020

¹¹⁶ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹¹⁷ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

jo të duhur nga institucionet publike. Një OShC e intervistuar¹¹⁸ shpjegon se "problemi shfaqet kur Ministria planifikon buxhetin për financimin e shërbimeve sociale. Buxheti llogaritet si formë e kostove të ofrimit të shërbimit në tërësi, e jo për numrin e personave që do të përfitojnë nga shërbimi. Si rezultat, fondet e siguruar nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar tërë ciklin e ofrimit të një shërbimi. Kjo është arsyeja pse shumica e strehimoreve duhet të pezullojnë aktivitetet e tyre në fund të vitit." Nga 13 organizata që kanë fituar kontrata shtetërore, shtatë¹¹⁹ prej tyre pohuan se nuk kishin pranuar fonde në kohë dhe kishin pasur probleme gjatë ofrimit të shërbimeve. Tri organizata theksuan se kishin pranuar fonde në kohë, teksa tri të tjera deklaruan se ishin përballur me vonesa, mirëpo humbjet ishin mbuluar nga institucionet publike.¹²⁰

3.3.3. Procedurat për kontraktimin e shërbimeve

Mjedis pjesërisht i favorshëm është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Ligji për Prokurimin Publik dhe Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare mbeten të paqarta, posaçërisht në aspektin e procedurave të përzgjedhjes së ofruesve të shërbimeve. Udhëzimi administrativ i miratuar në vitin 2015 përcakton kriteret dhe procedurat e përgjithshme të financimit për OShC-të që ofrojnë shërbime sociale, sikurse udhëzimi administrativ për shërbimet për personat e riatdhesuar. Ligji për prokurimin publik përmban kriteret specifike për të garantuar procedura të hapura dhe transparente gjatë prokurimit publik, ndërsa rregullat dhe procedurat e përzgjedhjes së OShC-ve për ofrimin e shërbimeve duhet akoma të përcaktohen përmes legjisllacionit sekondar. Duke filluar nga viti 2016, i tërë procesi i prokurimit publik realizohet përmes platformës në internet për prokurimin publik. Kjo platformë ka për qëllim rritjen e transparencës dhe konkurrencës, duke ua siguruar qytetarëve qasje në dokumentet e tenderit. Pas hyrjes në fuqi të Rregullores për ndarjen e fondeve publike, ka një rritje të trendit të ofruesve të shërbimeve që përzgjedhen përmes saj. Ndërkohë, kjo nuk është në rregull pasi që Rregullorja mbulon financimin publik të projekteve dhe programeve të OShC-ve, por jo edhe të shërbimeve të tyre. Meqenëse financimi i shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera trajtohet përmes granteve dhe subvencioneve, si dhe i nënshtrohet kriterëve shumë të përgjithshme, është e vështirë të vlerësohet nëse çmimi nuk është kriteri kryesor i vendimeve për financim.

Baza ligjore parashikon dispozita të përgjithshme që trajtojnë konfliktin e interesit në kuadër të ofrimit të shërbimeve sociale nga OShC-të. Për ofrimin e shërbimeve në fushën e arsimit, korniza ligjore nuk parashikon ndonjë parandalim të konfliktit të interesit. Aktet nënligjore për ofrimin e shërbimeve sociale kërkojnë që procedurat të jenë të hapura dhe transparente, megjithëse kjo nuk vlen për ofrimin e shërbimeve në fushën e arsimit. Ligji parashikon të drejtën e ankesës ndaj vendimeve. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe Agjencia kundër Korrupsion janë dy mekanizmat për zbulimin dhe sanksionimin e shpërdorimit në prokurimin publik. Në vitin 2019, 26 OShC¹²¹ janë kontraktuar për ofrimin e shërbimeve sociale. Fushat më të rëndomta janë: shërbimet sociale, trajnimet profesionale, trajnimi i shkathtësive të buta dhe aktivitetet për promovimin e të drejtave të njeriut. Rreth 48 përqind¹²² e OShC-ve të anketuara konsiderojnë se dhënia e kontratave shtetërore nuk është as transparente dhe as e drejtë. Intervista¹²³ me një organizatë që monitoron prokurimin publik në nivel lokal nxori në pah se në realitet, çmimi është kriteri kryesor. Kriteret tjera, siç janë numri i përfituesve, OShC-të dhe certifikimi i stafit rrallë merren në konsideratë. Sa i përket efektshmërisë së mekanizmave të monitorimit që janë

¹¹⁸ Intervista me Koalicionin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve Kosovë, 1 nëntor 2019

¹¹⁹ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹²⁰ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹²¹ Kërkesa për qasje në informata publike të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, 14 maj 2020

¹²² Kërkesa për qasje në informata publike të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, 14 maj 2020

¹²³ Intervista me Iniciativën për Progres, 2 qershor 2020

në funksion, organizata theksoi se "edhe pse ata janë njoftuar për shkeljet që janë kryer në praktikë, nuk kemi pranuar ndonjë informacion nëse kanë filluar apo jo të ndërmerren masat e nevojshme". Tre zyrtarë publikë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë marrë pjesë në trajnime për kontraktimin e ofruesve të shërbimeve sociale.

3.3.4. Llogaridhënia, monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimeve

Mjedis i kufizuar për operim është kategoria e caktuar bazuar në gjetjet e këtij standardi.

Përveç shërbimeve sociale, shërbimet tjera nuk mbështeten mbi ndonjë bazë ligjore specifike për monitorimin e shpenzimeve dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve. Ofrimi i shërbimeve nga OShC-të iu nënshtrohet kërkesave të përgjithshme ligjore për shpenzimet publike. Legjisllacioni sekondar, i cili u miratua në vitin 2015, përfshinë disa dispozita të përgjithshme për monitorimin e shërbimeve të financuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Pjesa më e madhe e monitorimit përqendrohet në verifikimin e shpenzimeve dhe në aspektet teknike të ofrimit të shërbimeve, me pak monitorim dhe vlerësim cilësor. Nuk ka raste të identifikuar të vlerësimit të rregullt të cilësisë dhe të efekteve/ndikimit që kanë pasur shërbimet e ofruara. Në përgjithësi, sistemi i llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të shërbimeve të ofruara nga OShC-të mbetet prapa. Komisioni i monitorimit është organi i autorizuar që monitoron dhënien e granteve dhe subvencione për subjektet juridike, duke përfshirë OShC-të. Monitorimi mund të kryhet nga institucionet e nivelit qendror ose lokal, varësisht nga lokacioni ku ofrohet shërbimi. Udhëzimi Administrativ për monitorimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare përcakton kompetencat e zyrtarëve/komisioneve të monitorimit, duke përfshirë një referencë gjithëpërfshirëse për monitorimin cilësor të shërbimeve. Nga ana tjetër, Udhëzimi Administrativ për ofrimin e shërbimeve arsimore kërkon vetëm dorëzimin e një raporti përshkrues në fund të raportit financiar. Tetëdhjetë e tre përqind¹²⁴ e OShC-ve që kanë fituar kontrata shtetërore pohuan se monitorimi i shpenzimeve dhe cilësisë së shërbimit është i rregullt dhe jo i tepruar. Kur u kërkua që ta bëjnë krahasimin në mes të monitorimit të shpenzimeve dhe cilësisë së shërbimeve publike të ofruara nga OShC-të dhe ofruesit tjerë të sektorit të shërbimeve, rreth 64 përqind¹²⁵ e të anketuarve deklaruan se institucionet shtetërore aplikuan të njëjtat kritere. Hulumtimet nga zyra kanë treguar se asnjë nga ofruesit kryesorë të kontratave shtetërore për OShC-të nuk kanë publikuar në internet raportet e tyre të monitorimit dhe vlerësimit. Megjithatë, qasja në informacionin publik ka nxjerr në pah se ka pasur monitorim të ofruesve të shërbimeve sociale, ndërsa raportet e tilla pritet të shkëmbehen me publikun.

Kutia 7: Vlerësimi i udhëzuesit të BE-së për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit

Objektivi nr. Rezultati nr. Korniza ligjore për ofrimin e shërbimit publik është në proces të ndryshimit. Kjo kornizë ka për qëllim përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e transparencës, si dhe krijimin e një sistemi të qëndrueshëm financiar. Kërkesat ligjore për t'u angazhuar në ofrimin e shërbimeve publike janë të barabarta për OShC-të dhe subjektet tjera juridike. Praktika tregon se vetëm tri nga 16 OShC-të që kanë aplikuar, janë përzgjedhur për të ofruar shërbime publike.

¹²⁴ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

¹²⁵ Anketa me OShC në Kosovë, e zhvilluar në shtator 2019

Konkluzionet dhe rekomandimet

Kohëve të fundit, tema e zhvillimit të shoqërisë civile është bërë gradualisht pjesë e agjendës së Qeverisë së Kosovës për të përmirësuar kornizën ligjore. Kjo është pjesërisht si rezultat i ushtrimit të trysnisë dhe avokimit afatgjatë nga shoqëria civile. Ligji për Lirinë e Asocimit në OJQ, Rregullorja për financimin publik të OJQ-ve, Rregullorja për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, Strategjia qeveritare - e dyta me radhë - për bashkëpunimin me shoqërinë civile, janë që të gjitha themelet e krijimit të një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile. Është më se e qartë se institucionet publike duhet të bëjnë më shumë në aspektin e krijimit të mekanizmave të nevojshëm për zbatimin e duhur të këtyre politikave dhe ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve civilë.

Mbetet një mundësi e madhe për përmirësim në lidhje me kornizën ligjore të PPP/LFT, e cila pa ndonjë vlerësim sektorial ose analizë paraprake e konsideron sektorin e shoqërisë civile të rrezikuar ndaj financimit të terrorizmit.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes vazhdon të mbetet brenda standardeve ndërkombëtare, megjithatë, organizatat e shoqërisë civile duhet të jenë të vëmendshme ndaj orvatjeve për ta rrezikuar ose luftuar atë.

Rekomandimi 1

Departamenti për OJQ-të duhet të hartojë aktet nënligjore të Ligjit për OJQ-të me përfshirjen e OJQ-ve. Për më tepër, D-OJQ duhet të ngrisë kapacitetet e saj për të zbatuar plotësisht mandatin e tij. Personeli i D-OJQ duhet të trajnohet në lidhje me parimet ndërkombëtare të lirisë së asociimit dhe dispozitat e reja të përfshira në ligjin për OJQ-të, të miratuar rishtazi.

Rekomandimi 2

Njësia për Inteligjencë Financiare, Ministria e Financave dhe Banka Qendrore duhet të hartojnë dhe miratojnë kornizën rregullative për bankat dhe OShC-të bazuar në rekomandimin 8 të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF), përkatësisht të kryejnë vlerësimin e rrezikut sektorial, për të mundësuar shërbime të pakufizuara financiare për OShC-të dhe për të inkurajuar transaksionet bankare në kuadër të operacioneve financiare të OShC-ve.

Rekomandimi 3

Ministria e Financave dhe Administrata Tatimore duhet t'i trajtojnë specifikat e OShC-ve në legjislacionin primar, si dhe format e raportimit. Këto duhet të harmonizohen me Ligjin për OJQ-të për të siguruar përfitime specifike për OShC-të. Duhet të ngriten kapacitetet e nëpunësve civilë, në mënyrë që procedurat administrative në lidhje me lirimimin nga tatimi për OShC-të dhe donatorët të zhvillohen në mënyrë më efektive.

Rekomandimi 4

Ministria e Financave, së bashku me organizatat tjera buxhetore të nivelit qendror dhe lokal, duhet të punojnë në rritjen e transparencës në lidhje me fondet publike që iu janë ndarë OJQ-ve, me fokus në monitorim dhe vlerësim. Duhet të përmirësohet sistemi i ruajtjes së të dhënave në aspektin e përfituesve dhe shumave që u ndahen OJQ-ve. Gjithashtu, duhet të ngriten më tepër kapacitetet e zyrtarëve publik për të zbatuar në

tërësi kërkesat që derivojnë nga Rregullorja për fondet publike

Rekomandimi 5

Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZQM ZKM) duhet të ndajë një buxhet të caktuar dhe të ngrisë kapacitetet e saja njerëzore për zbatimin e duhur të Strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile. Përveç kësaj, metodologjia e vlerësimit të zbatimit të Strategjisë duhet të përditësohet, në mënyrë që të mundësohet një prezantim gjithëpërmbledhës dhe i saktë i të dhënave.

Rekomandimi 6

Institucionet e nivelit qendror duhet të sigurojnë që proceset e konsultimit publik të organizohen tërësisht në përputhje me standardet e specifikuara në Rregulloren për konsultimin publik. Duhet të rritet përqindja e hartimit të politikave dhe projektligjeve të pranishme në kriteret për një konsultim efektiv publik. Përveç platformës në internet për konsultim publik, duhet të shfrytëzohen edhe mjetet tjera të konsultimit, për të mundësuar më shumë qasje për OShC-të dhe mbarë qytetarët. Së fundi, duke u bazuar në qëndrimin pozitiv dhe gatishmërinë e një numri të nëpunësve civilë, në përgjithësi, duhet të fuqizohen kapacitetet e nëpunësve civilë për zbatimin e Rregullores, teksa OShC-të duhet të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e saj.

Sa i përket nivelit lokal, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe komunat duhet të punojnë për të funksionalizuar në tërësi zbatimin e standardeve minimale për procesin e konsultimit publik në nivel lokal, ndërsa gjithashtu marrin përsipër zhvillimin e fushatës informative duke promovuar kështu mundësitë që janë në dispozicion për qytetarët dhe OShC-të.

Shtojcat

1. Metodologjia e matricës së monitorimit

Ky studim ndërthur metodat cilësore dhe sasiore të hulumtimit për të nxjerrë të dhënat e nevojshme, në mënyrë që të kuptohet gjendja aktuale e zhvillimit të shoqërisë civile në Kosovë. KCSF, si pjesë e aktiviteteve të saj të përditshme, gjatë gjithë vitit monitoron në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet e secilit prej standardeve të Matricës së Monitorimit. Gjithashtu, si organizatë kryesore në fushën e zhvillimit të shoqërisë civile në Kosovë, KCSF merr pjesë drejtpërdrejt në shumicën e iniciativave për përmirësimin e legjislacionit dhe praktikës së krijimit të mjedisit të favorshëm për shoqërinë civile. Ngjashëm ka vazhduar edhe angazhimi gjatë vitit 2019.

Hulumtimi nga zyra ka luajtur një rol të rëndësishëm në identifikimin e kornizës ligjore, duke përmbledhur kështu të 24 standardet e raportit të Matricës së Monitorimit. Më pas, përmbajtja e kornizës ligjore është analizuar dhe krahasuar me treguesit e Matricës së Monitorimit mbi Krijimin e Mjedisit të Favorshëm për të vlerësuar nivelin aktual të kushteve favorizuese. Rishikimi i kornizës ligjore na mundësoi që të krijojmë një pasqyrë të përgjithshme të politikave dhe ligjeve që prekin dhe rregullojnë sektorin e shoqërisë civile në Kosovë. Hapi tjetër përfshiu analizimin e nivelit të zbatimit të politikave dhe ligjeve të tilla.

Për këtë qëllim, janë anketuar gjithsej 101 organizata të shoqërisë civile në Kosovë. Mostra e anketës së OShC-ve është përpiluar duke u bazuar në regjistrin elektronik të OJQ-ve, të krijuar nga Departamenti për OJQ-të në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Lista përfshinë gjithsej 10,125 organizata vendore dhe 545 organizata të huaja dhe ndërkombëtare. Ky është një pyetësor i standardizuar që shfrytëzohet nga të gjithë partnerët rajonal, teksa në Kosovë është integruar në pyetësorin me organizatat të shoqërisë civile që gjithashtu aplikohet për Indeksën Kosovare të Shoqërisë Civile. Me qëllim të grumbullimit të informacioneve gjithëpërfshirëse dhe përfaqësuese rreth sektorit, nga aspekti i përmasës, fushëveprimit, viteve të angazhimit me sektorin dhe shpërndarjes gjeografike të OShC-ve, është aplikuar metodologjia e shtresuar përmes zgjedhjes së mostrës së rastësishme. Mostra e studimit u përzgjedh duke zbatuar dy hapa:

1) Përcaktimi i objektivave për kategoritë e shtresës/objektivit: 10 OShC të mëdha dhe të qëndrueshme, pesë OShC ndërkombëtare, 5 OShC nga komuniteti serb dhe 5 OShC nga komunitetet tjera etnike (jo-shqiptare dhe jo-serbe). Për të siguruar përfaqësimin gjeografik të organizatave, të anketuarit gjithashtu u veçuan përgjatë rajoneve si në vijim: së paku 15 OShC nga Prishtina dhe së paku 10 OShC nga rajonet tjera kryesore të Kosovës. Përveç kësaj, në secilën prej nën-mostrave rajonale, të paktën një OShC nga komunat më të vogla ose zonat rurale është përzgjedhur si mostër për të fituar njohuri rreth ndryshimeve me të cilat ata përballen në punët e tyre të përditshme. OShC-të nga komuniteti serb u përzgjedhën si mostër në të gjitha komunat me shumicë serbe: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq, Graçanicë dhe Shterpcë.

2) Përzgjedhja e rastësishme e OShC-ve nga secila shtresë/kategori, bazuar në listën e OJQ-ve të regjistruara. Për shkak të shkallës së lartë të OShC-ve joaktive nga Regjistri Publik i OJQ-ve, metodologjia e njëjtë e përzgjedhjes së mostrave u përsërit disa herë, derisa u arrit totali i përzgjedhjes së mostrës së synuar.

Korniza ligjore dhe anketa u plotësuan me gjithsej tetë intervista me përfaqësuesit e sektorit të shoqërisë civile dhe nëpunësit civilë. Secila intervistë përfshiu një grup të caktuar të pyetjeve, varësisht nga fusha e ekspertizës dhe përvoja e të intervistuarve. Sipas preferencës, intervistat u zhvilluan me shkrim ose përmes takimeve të drejtpërdrejta. Përveç kësaj, u shfrytëzuan kërkesat për qasje në informata publike. U siguruan njëzet e një përgjigje, tre nga institucionet e nivelit qendror dhe pjesa tjetër nga komunat e Kosovës. Mirëpo, si intervistat ashtu edhe kërkesat për qasje në informata publike u shoqëruan me kufizimin e lëvizjes, si pasojë e pandemisë së COVID-19, gjë që e imponoi nevojën për të zhvilluar dy herë procesin e kontaktimit të akterëve relevantë, në mënyrë që të shtohet në maksimum grumbullimi i të dhënave. Iu jemi referuar edhe raporteve të palëve të treta. Rëndësia e intervistave dhe kërkesave për qasje në informata publike na mundësoi që të aplikojmë disa metoda për të siguruar të dhëna nga burime të ndryshme (triangulate data), në mënyrë që këto të plotësohen me njëra-tjetrën.

2. Shënime mbi metodologjinë dhe sfidat

Raporti i Matricës së Monitorimit 2019 është hartuar duke u bazuar në metodologjinë e përditësuar, e cila është zhvilluar në bashkëpunim me partnerët e BCSDN-së. Procedurat e nevojshme për grumbullimin e informatave ishin praktike dhe të dobishme. Sidoqoftë, intervistat e para që ishin planifikuar të zhvilloheshin u shoqëruan me shfaqjen e rasteve të para me koronavirus në Kosovë, të cilat e çuan tërë vendin në izolim. Përderisa kufizimi i lëvizjes ishte duke u hequr, KCSF, ashtu siç ishte planifikuar, vazhdoi t'i kontaktojë menjëherë palët e interesuara.

Çdo analizë e shoqërisë civile që bazohet në të dhënat empirike është një orvatje sfiduese në Kosovë, për shkak të mungesës së të dhënave në dispozicion nga Agjencia e Statistikave ose institucionet tjera përkatëse. Rrjedhimisht, llogaritja e të dhënave të nevojshme, kryesisht për vlerën ekonomike të sektorit, përfshinë ndërthurjen e burimeve të ndryshme të informatave nga disa institucione publike. Megjithatë ky është një proces kohë-harxhues, zyrtarët publikë janë të përkushtuar të ofrojnë informata në kohë. Disa të dhëna ekzistojnë. Për shembull, D-OJQ kontrollon numrin e OShC-ve të regjistruara dhe aktive në Kosovë, ndërsa Ministria e Financave mban evidencën e listës së përfituesve. Mirëpo, në të shumtën e rasteve të dhënat nuk ruhen në mënyrë sistematike. Prandaj, KCSF-së iu është nevojitur të kryente punë shtesë për t'i korrigjuar dhe analizuar ato. Një tjetër sfidë ishte legjislacioni i fragmentuar së tepërmi, i cili përmban dispozita të veçanta që janë të rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë civile. Shumica e dispozitave të veçanta ishin "të fshehura" në një numër të madh të ligjeve dhe udhëzimeve administrative, teksa për kërkime në këtë sistem të ndërlikuar të legjislacionit dhe ndërlikohen e duhur të tyre është nevojitur punë e mundimshme në hulumtimin nga zyra dhe analizën e këtyre dokumenteve. Si përfundim, KCSF, si pjesë e aktiviteteve të saj të përditshme, gjatë gjithë vitit monitoron në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet kryesore të secilit prej standardeve. Kjo ia mundëson ekipit hulumtues ta përqendrojë hulumtimin kryesor vetëm tek çështjet që kanë pasur nevojë për informata dhe analiza të mëtejshme. Për më tepër, duke qenë organizatë kryesore në fushën e zhvillimit të shoqërisë civile në Kosovë, KCSF merr pjesë drejtpërdrejt në shumicën e iniciativave për avancimin e legjislacionit dhe praktikës së krijimit të mjedisit të favorshëm për shoqërinë civile.

3. Burimet e shfrytëzuara/Bibliografia

1. Kushtetuta e Kosovës
2. Kodi nr. 04/L-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës
3. Ligji nr. 02/L-65 Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes
4. Ligji nr. 06/L-043 për Lirinë e Asocimit në OJQ-të
5. Ligji 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (përfshirë Ligjin 04/L-102 për ndryshimin e Ligjit 03/L-222)
6. Ligji 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit
7. Ligji 03/L-196 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit (Përfshirë Ligjin 04/L-178 për ndryshimin e Ligjit 03/L-196)
8. Ligji 03/L-162 për Tatimin në Të Ardhurat e Korporatave (përfshirë Ligjin 04/L-103 për ndryshimin e Ligjit 03/L-162)
9. Ligji 05/L-029 për Tatimin në Të Ardhurat e Korporatave
10. Ligji 03/L-161 për Tatimin në Të Ardhurat Personale (përfshirë Ligjin 04/L-104 për ndryshimin e ligjit 03/L-161)
11. Ligji 05/L-028 për Tatimin në Të Ardhurat Personale
12. Ligji 03/L-118 për Tubimet Publike
13. Ligji 03/L-212 i Punës
14. Ligji 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë
15. Ligji për Buxhetin e vitit 2016
16. Ligji 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik
17. Ligji 03-L/040 për Vetëqeverisjen Lokale
18. Ligji 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike
19. Ligji 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare
20. Vendimi Shpjegues Publik 06/2016 i Administratës Tatimore për trajtimin tatimor të donacioneve
21. Rregullorja 05/2016 për Standardet Minimale për procesin e konsultimit publik
22. Rregullorja MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve
23. Udhëzimi Administrativ QRK – Nr: 02/2014 për regjistrimin dhe funksionimin e OJQ've
24. Deklarata për partneritet ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe shoqërisë civile
25. Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019 - 2023
26. Modeli qeveritar për financim publik
27. Raporti i Qeverisë për financim publik 2019

28. Plani vjetor për vitin 2016 i strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017
29. Raporti vjetor për konsultimet publike për vitin 2018
30. Raporti i monitorimit të KCSF-së mbi zbatimin e standardeve minimale për konsultimet publike 2018
31. Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile 2016, KCSF 2018
32. Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (në rast të kërkesës ofrohen të dhënat)

4. Lista e të intervistuarve

Sipas rendit alfabetik:

1. Albulena Nrecaj, Iniciativa për Progres
2. Donjetë Kelmendi, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve Kosovë
3. Feride Rushiti, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
4. Kastriot Miftaraj, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
5. Kushtrim Kaloshi, Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim
6. Liron Kafexholli, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
7. Musli Krasniqi, Kuvendi i Kosovës